



---

# KUJDES ME PVGJ-NË

VLERËSIM I PAVARUR I ZBATIMIT TË PLANIT II TË  
VEPRIMIT GJINOR TË BE-SË NË VENDET E  
BALLKANIT PERËNDIMOR

Nga Nicole Farnsworth dhe Iliriana Banjska  
për Rrjetin e Grave të Kosovës



*Rrjeti i Grave të Kosovës*

*Mbështet, miron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë*

**KVINNA**  
**KVINNA**

# Pasqyra e lëndës

Mirënjohje.....	3
Akronimet dhe shkurtesat.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
Hyrje.....	7
Gjetjet.....	8
Objektivi 1. Rritja e koherencës dhe koordinimit midis institucioneve të BE-së dhe me shtetet anëtare.....	8
Objektivi 2. Krijimi i lidershipit të dedikuar ndaj barazisë gjinore dhe fuqizimit të vajzave dhe grave në institucionet dhe shtetet anëtare të BE-së .....	10
Objektivi 3. Alokimi i burimeve të mjaftueshme nga ana e institucioneve dhe shteteve anëtare të BE-së për të zbatuar angazhimet e BE-së për politikën gjinore .....	12
Objektivi 4. Përdorimi i provave të shumta gjinore si mjet informues për të gjitha shpenzimet e jashtme të BE-së, programimin dhe politikëbërjen .....	15
Objektivi 5. Matja e rezultateve për gratë dhe vajzat dhe alokimi i burimeve për gjurmimin sistematik të ecurisë .....	20
Objektivi 6. Nxitja e partneriteteve midis BE-së dhe palëve të interesuara për të ngritur kapacitetet kombëtare për barazinë gjinore.....	22
Objektivi 18. Organizatat e grave dhe OSHC-të e tjera dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut që punojnë për barazinë gjinore dhe fuqizimin dhe të drejtat e grave dhe vajzave të jenë në gjendje të punojnë pa pengesa dhe të mbrohen nga ligji.....	24
Çështje të tjera dhe mësimet e nxjerra për PVGJ-në III.....	25
Rekomandime.....	26
Për SHVJE-në.....	26
Për KE-në.....	26
Për DBE-të.....	27
Për PVGJ-në III.....	28
Burimet e cituara.....	29
Shtojca 1. Vështrim i përgjithshëm i zbatimit sipas treguesve.....	30
Shtojca 2. Metodologjia.....	36
Shtojca 3. Personat me të cilët janë zhvilluar konsulta.....	37
Shtojca 4. Treguesit problematikë të PVGJ-së II.....	41

---

## MIRËNJOHJE

---

Rrjeti i Grave të Kosovës falënderon Fondacionin “Kvinna till Kvinna” për përkrahjen e vazhdueshme, sidomos Brigitta Jaksa-n, e cila ka ofruar mbështetje të pandërprerë gjatë procesit të punës dhe Maja Stajcic Riza Aragon, e cila ndihmoi në organizimin e intervistave. Ky punim nuk do ta shihte dritën pa bashkëpunimin e ngushtë me organizatat tona partnere në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Pikat Fokale Gjinore në kuadër të Delegacioneve të BE-së, të cilat organizuan takime me palët përkatëse të interesuara. I falënderojmë të gjithë ata që kontribuan në këtë punim për kohën e çmuar dhe mendimet e tyre.

---

## AKRONIMET DHE SHKURTESAT

---

DV	Dokumentet e Veprimit
SPIMJ	Sistemi i Përbashkët Informativ për Marrëdhëniet e Jashtme
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
KAZH	Komiteti i Asistencës Zhvillimore
DPFMNZ	Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë e Mirë dhe Negociatat e Zgjerimit
RMVJ	Raportet për Menaxhimin e Veprimit të Jashtëm
KE	Komisioni Evropian
ECHO	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen Civile Evropiane dhe Operacionet e Ndihmës Humanitare
SHVJE	Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian
IEDDNJ	Instrumenti Evropian për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian
KRBE	Korniza e Rezultateve të BE-së
PVGJ	Plani i Veprimit Gjinor
PFGJ	Pika/Personi Fokal Gjinor
ZQ	Zyrat Qendrore
IPA	Instrumenti i Para-Anëtarësimit
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
SHA	Shtet Anëtar (i BE-së)
SHAM	Shqyrtim afatmesëm
N/A	E paaplikueshme apo e padisponueshme
MKBGJ	Mekanizmat Kombëtarë të Barazisë Gjinore
OBEZH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
QZHQ	Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
DPP	Dokument pune i personelit (që ka të bëjë me PVGJ II)
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
BP	Ballkani Perëndimor
OSHCG	Organizatë e shoqërisë civile për të drejtat e grave

---

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Në vitin 2015, Komisioni Evropian (KE) dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian miratuan Planin e dytë të Veprimit Gjinator, PVGJ II. Qëllimi i këtij plani është të avancojë më tutje barazinë gjinore në të gjitha veprimtaritë dhe marrëdhëniet e Bashkimit Evropian (BE). Në gusht të vitit 2017, KE-ja publikoi raportin e saj të parë për zbatimin e PVGJ-së II në vitin 2016. Raportit i mungonin informacionet e mjaftueshme lidhur me zbatimin e PVGJ-së II në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP), gjë që ua bënte të vështirë aktorëve të BE-së të identifikonin sfidat specifike të vendit dhe rajonit gjatë zbatimit të PVGJ-së II. Poashtu edhe organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHCG) u mungonin të dhëna të cilat do t'u mundësonin atyre të përkrahnin aktorët e BE-së në zbatimin e PVGJ-së II.

Për këto arsye, në vjeshtën e vitit 2017, Fondacioni "Kvinna till Kvinna", Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe OSHCG partnere vendosën të vlerësonin zbatimin e PVGJ-së II në vendet e BP-së. Gjatë vlerësimit u shqyrtua shkalla në të cilën BE ka zbatuar PVGJ-në II në secilin vend, duke identifikuar praktikën më të mira, sfidat dhe mundësitë për çuarjen përpara të zbatimit të PVGJ-së II gjatë periudhës 2018-2020. Vlerësimi u përqendrua te zbatimi i prioritetit strategjik të PVGJ-së II për "Ndryshimin e kulturës institucionale" nga ana e delegacioneve të BE-së (DBE). Në këtë vlerësim, nuk u shqyrtuan të gjitha shtyllat e PVGJ-së II. Në këtë përmbledhje paraqiten gjetjet kryesore dhe rekomandimet. Rekomandimet në fund të këtij punimi identifikojnë palët specifike të interesit të cilat janë përgjegjëse.

### **OBJEKTIVI I 1-RË I PVGJ-SË II. RITJA E KOHERENCËS DHE KOORDINIMIT MIDIS INSTITUCIONEVE TË BE-SË DHE ME SHTETET ANËTARE (SHA)**

- DBE-të rrallëherë i kanë ngritur çështjet e barazisë gjinore te qeveritë gjatë dialogut politik, kryesisht për shkak se zyrtarët e BE-së nuk e konsideronin si prioritet barazinë gjinore. Megjithatë, ngritja e çështjeve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore në kuadrin e dialogut politik në të gjithë sektorët është pjesë përbërëse e agjendës "si fillim të merremi me gjërat themelore" dhe jo pjesë e shkëputur e saj.

#### **Rekomandime**

- Të sigurohet që udhëheqësit e delegacioneve dhe zyrtarët në seksionet politike të njohin përgjegjësitë që kanë sipas PVGJ-së II, duke përfshirë faktin se barazia gjinore duhet të jetë pjesë e agjendës "si fillim të merremi me gjërat themelore" dhe të ngrihet rregullisht gjatë dialogut të politikave dhe atij politik.

### **OBJEKTIVI I 2-TË. KRIJIMI I LIDERSHIPIT TË DEDIKUAR NDAJ BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMIT TË VAJZAVE DHE GRAVE NË INSTITUCIONE DHE SHA**

- Përqindja e udhëheqëseve të DBE-ve është rritur, megjithatë gratë vazhdojnë të mbeten të nën përfaqësuara.
- DBE-të nuk kanë emëruar kampione të çështjeve gjinore.
- Shkalla në të cilën menaxherët i kanë adresuar çështjet e barazisë gjinore duket se është varur më shumë nga vullneti individual sesa nga praktika e institucionalizuar.
- Treguesit e PVGJ-së II janë përzgjedhur në pjesën më të madhe të vendeve të BP-së, edhe pse në këtë proces janë përfshirë konsultime të pamjaftueshme me OSHCG.

#### **Rekomandime**

- Të emërohen më shumë gra si udhëheqëse të misionëve të BE-së kur të ketë shpallje për pozicione të lira.
- Të emërohen kampione të çështjeve gjinore, të paktën një kampion për secilin vend.
- Të institucionalizohet qasja ndaj çuarjes përpara të barazisë gjinore, duke siguruar që menaxherët t'i ngrenë rregullisht çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.
- Të zhvillohen konsultime me OSHCG-të gjatë përzgjedhjes së treguesve të PVGJ-së II në të ardhmen.

### **OBJEKTIVI I 3-TË. ALOKIMI I BURIMEVE TË MJAFTUESHME NGA ANA E INSTITUCIONEVE DHE SHTETEVE ANËTARE TË BE-SË PËR TË ZBATUAR ANGAZHIMET E BE-SË PËR POLITIKAT GJINORE**

- Për fat të keq, financimi për iniciativat që ndikojnë në përmirësimin e jetës për vajzat dhe gratë nuk u vlerësua gjatë shqyrtimit afatmesëm të vitit 2017.
- Sistemet aktuale të menaxhimit të të dhënave e bëjnë të pamundur monitorimin e saktë të financimeve për gratë dhe vajzat, barazinë gjinore dhe OSHCG-të.
- BE-ja nuk ka alokuar burime të mjaftueshme njerëzore për zbatimin e PVGJ-së II.
- Përshtimet e vendeve të punës nuk janë përditësuar, për të kërkuar që detyrat që kanë të bëjnë me barazinë gjinore të jenë përgjegjësi primare për të gjithë.
- Burimet njerëzore kanë trajnim të kufizuar, por të pamjaftueshëm, për integrimin e çështjeve gjinore në programimin e IPA-s.

#### **Rekomandime**

- Të shqyrtohen treguesit e PVGJ-së II dhe burimeve të të dhënave për përmirësimin e saktësisë, duke përfshirë këtu edhe kërkesën që për të gjithë këto të dhënat të ndahen sipas gjinisë.
- Të caktohen tregues për PVGJ-në II për “financime të dedikuara” për gratë dhe vajzat dhe OSHCG-të respektivisht.
- Të përmirësohen sistemet e menaxhimit të të dhënave, duke kërkuar që të raportohet për financimet e dedikuara për gratë dhe vajzat, barazinë gjinore dhe OSHCG-të, përkatësisht në OPSYS. Të publikohen rezultatet çdo vit, duke monitoruar prirjet.
- Të alokohen burime njerëzore të përshtatshme dhe të dedikuara për zbatimin e PVGJ-së II.
- Të sigurohet që i gjithë personeli i DBE-ve në të gjitha nivelet të kryejë trajnimin e detyrueshëm për barazinë gjinore, duke përfshirë trajnimin në shprehje praktike lidhur me integrimin e çështjeve gjinore.
- Të përditësohen urgjentisht përshtimet e punëve të të gjitha niveleve, për të përfshirë përgjegjësitë për barazinë gjinore të cilat janë me rëndësi për ato pozicione.

### **OBJEKTIVI I 4-TË. PËRDORIMI I PROVAVE TË FUQISHME GJINORE SI MJET INFORMUES PËR TË GJITHA SHPENZIMET E JASHTME TË BE-SË, PROGRAMIMIN DHE POLITIKËBËRJEN**

- Analizat gjinore janë kryer në të gjitha vendet. Megjithatë, të pakta kanë qenë programet që kanë përdorur analizat gjinore specifike për sektorët për të siguruar të dhëna për hartimin e tyre.
- DBE-të kanë marrë disa masa pozitive për të integruar më mirë çështjet gjinore në programimin e IPA-s.
- Megjithatë, meqenëse vendet përfituese hartojnë dokumentet e veprimit (DV) dhe duhet të marrin përgjegjësi për to, zyrtarët e DBE-ve shpeshherë kanë hezituar të ndërhyjnë në strategjitë ekzistuese dhe veprimet e planifikuara qeveritare, duke përfshirë nxitjen e qeverive për të adresuar pabarazitë gjinore në dokumente. Fakti që qeveritë dhe jo DBE-të i “kanë nën pronësi” këto dokumente dhe i mbështesin ato mbi strategji ekzistuese të qeverisë paraqet një sfidë thelbësore për të siguruar integrimin e barazisë gjinore në DV.
- DBE-të nuk janë konsultuar mjaftueshëm apo në mënyrë sistemore me Mekanizmat Kombëtarë të Barazisë Gjinore (MKBGJ), OSHC-të dhe OSHCG-të për të siguruar informacione për programet e IPA-s.
- Në të gjitha vendet e BP-së, OSHCG-të pohuan se kishin pak informacion, në mos fare, lidhur me procesin e anëtarësimit në BE, e lëre me për DV-të specifike.

### **Rekomandime**

- Edhe pse përgjegjësia përfundimtare mbi programimin është e vendeve përfituese, DBE-të mund dhe duhet të ushtrojnë më shumë presion politik lidhur me çuarjen përpara të barazisë gjinore, duke u dërguar qeverive një mesazh të qartë që barazia gjinore është një përparësi për BE-në dhe se duhet të jetë e tillë edhe për qeveritë.
- Të krijohet një proces i standardizuar i sigurimit të cilësisë së çështjeve gjinore me ekspertët e çështjeve gjinore duke shqyrtuar të gjitha DV-të.
- Të sigurohet kryerja e analizave gjinore për të siguruar të dhëna për të gjithë sektorët e DV-ve, ashtu siç parashikohet në PVGJ-në II.
- Gjatë hartimit të strategjive të reja qeveritare, ligjeve, analizave gjinore nga BE-ja, DV-ve dhe dokumenteve të tjera në përgjithësi, të sigurohet që si qeveria ashtu edhe DBE-të zhvillojnë konsultime të rregullta me MKBGJ-të dhe OSHCG-të. Këto konsultime do të mund të përkrahin edhe DBE-të gjatë mbledhjes së të dhënave hyrëse për të informuar më mirë dialogun politik nga perspektiva gjinore.

### **OBJKTIVI I 5-TË. MATJA E REZULTATEVE PËR GRATË DHE VAJZAT DHE ALOKIMI I BURIMEVE PËR GJURMIMIN SISTEMATIK TË ECURISË**

- Korniza e Rezultateve të BE-së (KRBE) nuk është harmonizuar me PVGJ-në II, ndërkohë që disa tregues të PVGJ-së II janë problematikë sepse nuk kërkojnë që të dhënat të ndahen sipas gjinive.
- Ekzistojnë disa sfida me përdorimin e Shënjeshtës Gjinore të OBEZH-it si tregues: ai mund të ofrojë informata çorientuese lidhur me burimet reale të alokuara për gratë dhe vajzat; zyrtarët priren të mos kenë njohuri të mjaftueshme rreth tij, gjë që kontribuon në subjektivitet dhe shënjime të pasakta; dhe logjistika e ndërhyrjes në kuadrin e mostrave të programimit të IPA-s kufizojnë prezantimin e objektivave të përgjithshme ose specifike që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, në drejtim të marrjes së një note G1 apo G2.

### **Rekomandime**

- Të sigurohet që rishikimet e planifikuara për KRBE-në të përfshijnë edhe treguesit e PVGJ-së II për raportimin e rregullt.
- Të shqyrtohen dhe rishikohen nga afër treguesit e PVGJ-së II për të siguruar që ata të kërkojnë në mënyrë specifike që të dhënat të ndahen sipas gjinive.

### **OBJKTIVI I 6-TË. NXITJA E PARTNERITETEVE MIDIS BE-SË DHE PALËVE TË INTERESUARA PËR TË NGRITUR KAPACITETET KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE**

- DBE-të kanë ndërmarrë fare pak nisma për të krijuar partneritete midis BE-së dhe palëve të interesuara për të ngritur kapacitetet kombëtare për barazi gjinore. Lidhur me këtë, DBE-të kanë ofruar pak ose aspak financime shtesë për hulumtimet mbi barazinë gjinore, për të çuar më tej kapacitetet e MKBGJ-ve dhe/ose për përmirësimin e raportimit mediatik mbi barazinë gjinore përkatësisht.
- Mekanizmat e koordinimit për barazinë gjinore ekzistojnë, por janë të dobët dhe shpeshherë aplikohen ad hoc.

### **Rekomandime**

- Të përmirësohet disponueshmëria e të dhënave duke alokuar më shumë burime për hulumtime dhe të dhëna statistikore që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.
- Të nxiten dhe përkrahen fuqishëm MKBGJ-të lokale në organizimin e takimeve sistematike për koordinimin gjinor ku përfshihen si palët kombëtare ashtu edhe ato ndërkombëtare të interesit, duke përfshirë OSHCG-të.

- Të alokohen burime financiare për ngritjen më tej të kapaciteteve të MKBGJ-ve për t'u angazhuar në proceset e anëtarësimit të vendeve në BE. Të nxiten fuqishëm vendet për t'i përfshirë MKBGJ-të në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve sektoriale.
- Të financohet ngritja e ndërgjegjes mediatike dhe raportimi për temat që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.

## **OBJEKTIVI I 18-TË. ORGANIZATAT E GRAVE DHE OSHC-TË E TJERA DHE MBROJTËSIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT QË PUNOJNË PËR BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN DHE TË DREJTAT E GRAVE DHE VAJZAVE TË JENË NË GJENDJE TË PUNOJNË PA PENGESA DHE TË MBROHEN NGA LIGJI**

- Treguesit aktualë përbëjnë mjete të dobëta matëse për përkrahjen që u jepet OSHCG-ve. Një tregues përqendrohet te mbrojtësit individual të të drejtave të njeriut të grave, por nuk merr parasysh përkrahjen ndaj OSHC-ve.
- Përkrahja e pamjaftueshme financiare për OSHC-të, sidomos në burime njerëzore, e pengon aftësinë e OSHCG-ve për të marrë pjesë në proceset e anëtarësimit në BE, duke përfshirë konsultimet dhe punët avokuese që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, sikurse parashihet në PVGJ-në II.

### **Rekomandime**

- Të kryhen matje dhe të bëhen raportime të rregullta lidhur me: përkrahjen financiare që u jepet OSHCG-ve dhe organizatave të tjera të OSHC-së që punojnë, përkatësisht, për barazinë gjinore dhe për fuqizimin dhe të drejtat e grave dhe vajzave.
- Të hiqen mënjandë fonde për përkrahjen e OSHCG-ve, duke përfshirë mbrojtësit e të drejtave të grave si të drejta të njeriut, sidomos në lidhje me përkrahjen e tyre ndaj zbatimit të PVGJ-së II dhe integritet të çështjeve gjinore në proceset e anëtarësimit në BE.

---

## **HYRJE**

---

Në shtatorin e vitit 2015, Komisioni Evropian (KE) dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian (SHVJE) miratuan një Dokument Pune për Personelin (DPP) të titulluar "Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020". Dokumenti, të cilit zakonisht i referohen si Plani i Veprimit Gjinor i dytë ose, më thjeshtë, "PVGJ II", synon të avancojë më tutje barazinë gjinore te të gjitha aktivitetet e jashtme dhe marrëdhëniet e Bashkimit Evropian (BE).<sup>1</sup> Pas mbështetjes publike nga Këshilli Evropian më 26 tetor 2015, PVGJ II identifikon disa "aktorë të BE-së" që janë përgjegjës për zbatimin e tij: Shërbimet e KE-së (duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësinë e Mirë dhe Negociatat e Zgjerimit, "DP FMNZ"<sup>2</sup> dhe SHVJE në dy zyrat qendrore (ZQ) dhe nivelet e Delegacioneve të BE-së (DBE)<sup>3</sup> si dhe shtetet anëtare (SHA) të BE-së.

PVGJ II përmban katër prioritetet strategjike. Prioriteti i parë strategjik ka të bëjë me "Ndryshimin e kulturës institucionale" si "parakusht për arritjen e barazisë gjinore". Tri "prioritete tematike" përqendrohen përkatësisht te integriteti fizik dhe psikologjik; të drejtat ekonomike dhe sociale; dhe zëri dhe pjesëmarrja. Aktorët e BE-së duhet të kryejnë "raportim sistematik" vjetor lidhur me objektivat që kanë të bëjnë me "ndryshimin e kulturës institucio-

<sup>1</sup> Marrë nga: [http://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-working-document-gender-2016-2020-20150922\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-working-document-gender-2016-2020-20150922_en.pdf)

<sup>2</sup> Krahas gjashtë vendeve të shqyrtuara në këtë punim, DP FMNZ-ja përfshin: Turqinë, Algjerinë, Egjiptin, Libanin, Palestinën, Armeninë, Gjeorgjinë, Libinë, Sirinë, Azerbajxhanin, Izraelin, Moldavinë, Tunizinë, Bjellorusinë, Jordaninë, Marokun dhe Ukrainën.

<sup>3</sup> Në këtë punim, për ta bërë leximin më të lehtë, akronimi "DBE" përdoret në përgjithësi për t'u referuar si delegacioneve të BE-së në vendet e BP-së, ashtu edhe Zyrës së BE-së në Kosovë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

nale”<sup>4</sup> Sipas Këshillit Evropian, “Rezultatet kundrejt masave dhe raportimi transparent lidhur me përparimin dhe pengesat priten, si praktikë e krijuar tashmë” në drejtim të përmirësimit “të efektivitetit të nismave të BE-së dhe të ndikimit të tyre mbi barazinë gjinore [dhe] llogaridhënien rreth nismave të BE-së ndaj institucioneve dhe qytetarëve të BE-së, dhe së fundmi përfituesve”.<sup>5</sup> Në këtë mënyrë, Këshilli nxit identifikimin e sukseseve dhe sfidave që kanë të bëjnë me zbatimin e PVGJ-së II, duke lehtësuar nxënien dhe aranzhimet mbështetëse në qasjen ndaj çuarjes përpara të zbatimit të PVGJ-së II dhe, në këtë mënyrë, edhe barazisë gjinore.

Në gusht të vitit 2017, KE-ja publikoi raportin e parë vjetor për zbatimin e PVGJ-së II në vitin 2016.<sup>6</sup> Në këtë raport shqyrtohet përparimi në të gjithë botën. Megjithatë, raporti përdori rajonet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH), të cilat janë të ndryshme nga rajonet e përcaktuara nga BE-ja. Raporti nuk përmbante të dhëna të mjaftueshme për vendet e Ballkanit Perëndimor (BP). Krahas kësaj, organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHCG) që veprojnë në BP nuk mendonin se raporti pasqyronte me saktësi përvojat që ato kishin pasur me PVGJ-në II. Në shtator, CONCORD publikoi një analizë të shkurtër të raportit vjetor të BE-së, ku dha rekomandime të tjera.<sup>7</sup> Megjithatë, as kjo analizë nuk ishte specifike për përvojat e vendeve të BP-së. Informacionet e mjaftueshme lidhur me zbatimin e PVGJ-së II në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) që ua bëjnë të vështirë aktorëve të BE-së të identifikonin sfidat specifike të vendit dhe rajonit gjatë zbatimit të PVGJ-së II. Gjithashtu, OSHCG-ve u mungonin të dhëna të cilat do t’u mundësonin atyre të përkrahnin aktorët e BE-së në zbatimin e PVGJ-së II.

Për këto arsye, Fondacioni “Kvinna till Kvinna”, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe OSHCG-të e tyre partnere në vendet e BP-së vendosën të kryenin një vlerësim të pavarur të PVGJ-së II në vendet e BP-së. Gjatë vlerësimit u kërkua të shqyrtohej shkalla në të cilën është zbatuar PVGJ-ja II në secilin vend, duke identifikuar praktikën më të mira, sfidat dhe mundësitë për çuarjen përpara të zbatimit të tij gjatë periudhës 2018-2020. Në këtë vlerësim, u shqyrta zbatimi i PVGJ-së II në vitin 2016, por edhe u mbledhën disa informata aktuale. Vlerësimi u përqendrua të prioriteti strategjik i PVGJ-së II “ndryshimi i kulturës institucionale”, mbështetur në supozimin se, duke marrë parasysh ciklet e programimit, do të ishte e vështirë të shqyrtohej ndikimi që ka të bëjë me tri prioritetet tematike pas vitit të parë të ekzistencës së PVGJ-së II. Gjithashtu, shqyrtimi i kontributit të SHA-ve në zbatimin e PVGJ-së II ishte përtej fushëveprimit të këtij vlerësimi.<sup>8</sup> Në vlerësim u përfshi shqyrtimi i dokumenteve përkatëse dhe i intervistave të kryera në shtator dhe tetor të vitit 2017 në shtatë pika në gjashtë vende të BP-së: Prishtinë, Sarajevë, Banja Luka, Beograd, Shkup, Tiranë dhe Podgoricë. RrGK-ja realizoi intervista të gjysmë-strukturuara individuale dhe në grup me 92 palë kyçe interesi nga këto pika dhe pika të tjera në çdo vend, duke përfshirë përfaqësues të DBE-ve, organe përkatëse qeveritare që koordinojnë proceset e anëtarësimit në BE, Mekanizmat Kombëtare të Barazisë Gjinore (MKBGJ), OSHCG, agjencitë e OKB-së.<sup>9</sup> Pyetjet kishin të bënin me objektivat dhe treguesit e renditur në pjesën “Ndryshimi i kulturës institucionale në Marrëdhëniet e Jashtme të Bashkimit Evropian” të kornizës së monitorimit dhe llogaridhënies së PVGJ-së II.

Në këtë punim përmbledhen gjetjet e vlerësimit. Sikurse inkurajon Këshilli Evropian, ky punim ofron informacione si për ecurinë ashtu edhe për pengesat drejt identifikimit të rekomandimeve të synuara për të gjitha palët e interesuara. Në këtë mënyrë, titulli i punimit u bën thirrje të gjitha palëve të interesuara që të kenë “Kujdes me PVGJ-në” në kuptimin që duhet t’u kushtojnë vëmendje PVGJ-së II dhe zbatimit të tij. Në të njëjtën kohë, titulli vë në dukje hendekun ekzistues midis objektivave të PVGJ-së II dhe zbatimit të tyre të plotë.

<sup>4</sup> Marrë nga: <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/26-fac-conclusions-gender-development/>.

<sup>5</sup> Konkluzionet e Këshillit, fq. 8.

<sup>6</sup> Dokument Pune i Personelit të Bashkuar, “Plani i Veprimit Gjinor të BE-së II: “Gender Equality and Women's Empowerment: Transforming the Lives of Girls and Women through EU External Relations 2016-2020 [Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: Transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes Marrëdhënies të Jashtme të BE-së 2016-2020]”, Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016, SWD(2017) 288 përfundimtar, Bruksel: 29 gusht 2017, marrë nga: <https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/10102/2017/EN/SWD-2017-288-F1-EN-MAIN-PART-1.PDF>.

<sup>7</sup> CONCORD, CONCORD Analysis and Recommendations Gender Action Plan Report 2016 [Analiza dhe rekomandimet e CONCORD-it: Raporti për veprimin gjinor 2016], 2017.

<sup>8</sup> Kjo do të kërkonte, në mënyrë të konsiderueshme, më shumë burime, domethënë kohë dhe burime njerëzore, nga ato që ishin të disponueshme.

<sup>9</sup> Në shtojcën 2 paraqiten hollësi të mëtejme rreth metodologjisë. Të gjitha gjetjet dhe citimet janë nga intervistat përveç rasteve kur përshkruhet ndryshe.



---

## GJETJET

---

Qëllimi i përgjithshëm i prioritetit "Ndryshimi i kulturës institucionale në Marrëdhëniet e Jashtme të Bashkimit Evropian" është që "BE-ja do të vazhdojë të sigurojë që angazhimet e veta për barazinë gjinore të përkthehen në rezultate të qarta e të prekshme dhe të shoqërohen me përmirësimin e koordinimit, koherencës, lidhshimit, provave dhe analizës gjinore dhe burimeve të përshtatshme financiare e njerëzore." Në këtë pjesë flitet për shkallën në të cilën DBE-të dhe aktorët e BE-së në BP kanë zbatuar secilin objektivi në raport me "ndryshimin e kulturës institucionale". Treguesit e PVGJ-së II janë përdorur për të matur përparimin, ndërsa gjetjet janë paraqitur në rend numerik, ashtu siç paraqiten në PVGJ-në II.<sup>10</sup>

### **OBJEKTIVI I 1-TË. RRIJTJA E KOHERENCËS DHE KOORDINIMIT NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË BE-SË DHE ME SHTETET ANËTARE (SHA)**

#### **Treguesi 1.1.2. Nr. i rasteve të dialogut të politikave/politikë midis aktorëve të BE-së dhe partnerëve në vend, ku çdo vit dhe në nivel vendi ngrihen çështje të barazisë gjinore**

Në aktorët përgjegjës për këtë tregues bëjnë pjesë shërbimet e Komisionit (KE), SHVJE-ja dhe SHA-të. Në raportin vjetor të zbatimit të PVGJ-së së BE-së i vitit 2016 i KE-së thuhet: "Ka pasur përparim të vogël në integrimin e perspektivave gjinore në dialogun politik dhe dialogun e politikave me partnerët."<sup>11</sup> Raporti ia atribuon këtë prioritet të programimit, faktit që treguesit e tjetër kyç ishin finalizuar përpara hyrjes në fuqi të PVGJ-së II dhe cilësisë së dobët të të dhënave për shkak të problematikave të konfidencialitetit. Ndërkohë që ka pasur dialog lidhur me dhunën ndaj grave, në fund të raportit thuhet se: "të pakta janë provat që dimensionet e barazisë gjinore janë në rindin e ditës të të gjithë rastet e dialogut".

Në vendet e BP-së, mbështetur në intervistat me përfaqësues të DBE-ve, numri i saktë që kërkohet për këtë tregues sasi duket se nuk është në dispozicion. Në aspektin cilësor, DBE-të kanë përshkruar disa shembuj. Në Mal të Zi, DBE-ja u fut në një dialog politik me qeverinë lidhur me politikën e re shtetërore të hartuar keq, e cila bëri që mijëra gra me tre ose më shumë fëmijë të largoheshin nga tregu i punës për përfitime shtetërore.<sup>12</sup> Në Bosnje dhe Hercegovinë, DBE-ja organizoi diskutime me kandidatet kryesore për kryetare të komunave gjatë zgjedhjeve. Në Maqedoni, problematikave të barazisë gjinore ngriheshin gjatë takimeve të nën-komiteve, siç ishin ai i Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme dhe në takimet me Ministrinë e Punës dhe Politikave Sociale. Në përgjithësi, si për-fundim, DBE-të vetëm në fare pak raste specifike i kanë ngritur problematikave të barazisë gjinore te qeveritë gjatë dialogut politik. Barazia gjinore nuk është diskutuar në mënyrë të vazhdueshme si pjesë e dialogut të politikave dhe dialogut politik që kanë të bëjnë me të gjithë sektorët. Mesa duket, disa çështje e pengonin përparimin lidhur me këtë tregues. Së pari, disa zyrtarë të DBE-së ose nuk kishin kurrfarë njohurie për PVGJ-në II, ose nuk dinin asgjë për këtë tregues. Njohuritë e varfra lidhur me përgjegjësinë e tyre për të ngritur problematikave të barazisë gjinore gjatë dialogut politikë ishin shkaku kryesor pse ata nuk kishin vepruar ashtu.

Së dyti, një lajtmotiv në radhët e zyrtarëve të DBE-së ishte se ata duhej të bënin "prioritizime"; barazia gjinore do të trajtohej pasi vendet të "merreshin me prioritetet", siç janë korrupsioni, paqëndrueshmëria politike dhe shteti i pafuqishëm i së drejtës. Duket se prioritetet "kombëtare" dhe "prioritetet e larta politike" kanë përparësi ndaj atyre që perceptohen si "problematika të buta", siç është barazia gjinore. Siç tha një zyrtar i BE-së, "Të jem i sinqertë, [...] çështjet gjinore nuk paraqesin prioritet." Zyrtarët e BE-së kanë prirjen ta interpretojnë agjendën e BE-së "si fillim të merremi me gjërat themelore" për të mos u marrë me pabarazinë gjinore, edhe pse barazia gjinore duhej të trajtohej si e drejtë themelore.

Problematikave kyçe të barazisë gjinore në BP kanë të bëjnë drejtpërdrejt, ndër të tjerash, me çështjet e të drejtave themelore për qasje në drejtësi (duke përfshirë krimet e dhunës për shkaqe gjinore), për pronë, për mos diskriminimin dhe për të drejtat e grave në punë. Kështu, trajtimi i çështjeve themelore "në fillim" nuk është në harmoni me adresimin e pabarazive gjinore.

<sup>9</sup> Në shtojcën 2 paraqiten hollësi të mëtejme rreth metodologjisë. Të gjitha gjetjet dhe citimet janë nga intervistat përveç rasteve kur përshkruhet ndryshe.

<sup>10</sup> Nuk janë diskutuar të gjithë treguesit e PVGJ-së II. Shihni Shtojcën I për informacione lidhur me shkaqet pse disa tregues u shqyrtuan ndërsa të tjerë jo.

<sup>11</sup> KE, Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016, fq. 3.

<sup>12</sup> Qendra e të Drejtave të Grave, "The Protest of Mothers: A Case Study [Protesta e nënave: Rast studimor]", korrik 2017; shihni: <http://www.rtcg.me/vijesti/drustvo/183838/bivse-korisnice-naknada-u-delegaciji-eu.html>.

Përkundrazi, adresimi i pabarazive gjinore është pjesë përbërëse e agjendës “si fillim të merremi me gjërat themelore”, sidomos e shtetit të së drejtës dhe të të drejtave themelore.<sup>13</sup> Reformat e shtetit të së drejtës duhet të adresojnë diskriminimin sistematik për shkaqe gjinore ndaj grave sepse ai sistem drejtësie që dështon të sigurojë qasje në drejtësi për gjysmën e popullsisë është sistem i dështuar.<sup>14</sup> Në veprimet për trajtimin e ekonomisë informale duhet të merret parasysh fakti se gratë kanë të ngjarë të jenë të mbipërfaqësuar në ekonomisë informale dhe reformat duhet të përdorin parimin “mos dëmto” gjatë adresimit të ekonomisë informale.<sup>15</sup> Pohimi se barazia gjinore nuk është përparësi thjesht vë në pah mosnjohjen e asaj se barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe se pjesa më e madhe e zyrtarëve të DBE-së nuk janë sa duhet të vetëdijshëm për atë që nënkupton integrimi gjinor dhe për mënyrën se si integrohen çështjet gjinore në reformat e politikave dhe dialogut politik.

Zyrtarët e DBE-së duken se nuk e kuptojnë rëndësinë dhe ndikimin e mundshëm që mund të kenë zyrtarët e BE-së duke ngritur problematikat e barazisë gjinore gjatë dialogut politik. Siç njihet edhe prej këtij treguesi të PV-Gj-së II, DBE-të duhet të luajnë një rol kyç në ushtrimin e presionit politik mbi qeveritë që këto ta marrin seriozisht barazinë gjinore si një vlerë themelore evropiane që është e lidhur me demokracinë dhe mos diskriminimin të cilat ata duhet t'i mbështesin dhe ruajnë.

## **OBJEKTIVI I 2-TË. KRIJIMI I LIDERSHIPIT TË DEDIKUAR NDAJ BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMIT TË VAJZAVE DHE GRAVE NË INSTITUCIONET DHE SHTETET ANËTARE**

### **Treguesi 2.1.1. Nr. i kampionëve të lartë për çështje gjinore të emëruar në nivelin e ZQ-së dhe vendit**

Kampioni i çështjeve gjinore është një person, krahas PFGJ-së, mundësisht në një pozitë të lartë, i cili promovon publikisht barazinë gjinore në emër të BE-së dhe merr përgjegjësinë të ngrejë rregullisht problematikat që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Kampion i çështjeve gjinore mund të jetë, për shembull, një ambasador nga BE-ja apo një shtet anëtar në vend, autoritetet lokale, një aktor lokal, gazetar, këngëtar, dhe/ose sportist apo sportiste e njohur. Për pjesën më të madhe të përfaqësuesve të DBE-ve, termi “kampion i çështjeve gjinore” duhet relativisht i panjohur dhe kuptohet pak, edhe pse Personat Fokalë Gjinorë (PFGJ)<sup>16</sup> në përgjithësi e njihnin këtë term. Asnjë prej DBE-ve në vendet e BP-së nuk kishte caktuar ende ndonjë kampion të çështjeve gjinore.

<sup>13</sup> Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e literaturës tregon se trajtimi i pabarazive gjinore si pjesë e proceseve të reformave priret të rezultojë në reforma më efikase, efektive dhe të qëndrueshme. Shihni: “The Frederick S. Pardee Center for the Study of Longer-Range Future, Are Women the Key to Sustainable Development?, Boston: 2010, marrë nga: <https://www.bu.edu/pardee/files/2010/04/UNsdkp003fsingle.pdf>.

<sup>14</sup> Kjo është një problematikë serioze në gjithë BP-në. Për shembull, shihni: Nicole Farnsworth, Ariana Qosaj-Mustafa, Iliriana Banjska, Adelina Berisha dhe Donjeta Morina për RrGK-në. “Mjaft më me arsytim: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reaguesve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë”, Prishtinë: RrGK, 2015, marrë nga: <https://www.womensnetwork.org/documents/20151124105025644.pdf>, dhe raporti i monitorimit i RrGK-së që do të dalë së shpejti (2018).

<sup>15</sup> Shihni: Chen, Martha, and Marilyn Carr, “Globalization, Social Exclusion and Work: With Special Reference to Informal Employment and Gender Globalizimi, përjashtimi social dhe puna: Vëmendje e posaçme ndaj punësimit informal dhe çështjeve gjinore”, International Labour Review 143, 2004, marrë nga: [http://www.inclusivcities.org/wpcontent/uploads/2012/08/Carr\\_Chen\\_ILO\\_Gen-der\\_and\\_Globalisation.pdf](http://www.inclusivcities.org/wpcontent/uploads/2012/08/Carr_Chen_ILO_Gen-der_and_Globalisation.pdf).

<sup>16</sup> Në shtojcën e Konkluzioneve të Këshillit për PVGJ-në II termat “Pika Fokale Gjinore” dhe “Personi Fokal Gjinor” përdoren këmbësor. Këtu, akronimi përdoret në të gjithë tekstin.



**IAq shumë mesazhe i dërgojmë qeverisë, saqë duhet të zgjedhim prioritetet.”**

ZYRTAR I BE-së

**Duhet ta kemi gjithmonë parasysh se jemi duke u marrë me një vend të varfër; duhet të caktohen prioritetet.”**

ZYRTAR I BE-së

**Tani prioritet është anëtarësimi. Nëse çështjet gjinore do të bëheshin prioritet, atëherë më shumë fonde do t'u dedikoheshin atyre.”**

ZYRTAR I BE-së



**Treguesi 2.2.1. Raporti i grave si udhëheqëse të misionëve të BE-së (të dhënat kontrolluese të vitit 2014: 24%)**

Në BP, raporti i udhëheqësve të misionëve të BE-së u përmirësua nga 17% që ishte në vitin 2014, ku një prej gjashtë DBE-ve udhëhiqej nga një grua (Romana Vlahutini në Shqipëri) në 33% në vitin 2016. Kjo rezultoi nga emërimi i përfaqësueses së re speciale të BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova. Që prej vjeshtës së vitit 2017, gratë vazhdojnë të udhëheqin gjashtë DBE, 33%.

Vihet re se, ndonëse është e rëndësishme në aspektin e baraspeshës gjinore, vendosja e grave në pozicione vendimmarrëse nuk sjell gjithmonë leadership të dedikuar ndaj barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Lidhur me këtë, përgjegjës janë si zyrtarët ashtu edhe zyrtaret e BE-së.

Vendi	2014.	2015.	2016.	2017.
Shqipëria	>1	1	1	1
Bosnja dhe Hercegovina	0	0	0	0
Kosova	0	0	0>1	1
Maqedonia	0	0	0	0
Mali i Zi	0	0	0	0
Serbia	0	0	0	0
Nr. i përgjithshëm i grave	1	1	2	2
% e përgjithshme e grave	17%	17%	33%	33%

Dhunës ndaj Grave.”<sup>17</sup> Raporti nuk shqyrton perceptimet e personelit të BE-së lidhur me performancën e menaxhimit.

Intervistat e RRGK-së me personelin jomenaxherial të DBE-ve të BP-së lënë të kuptohet se ekziston performancë e përzier lidhur me çuarjen tutje të barazisë gjinore, në varësi të menaxherit. Një menaxher i DBE-së fliste rregullisht për rëndësinë e barazisë gjinore gjatë takimeve me personelin dhe e nxiste personelin të zbatonte PVGJ-në II. Menaxherë të tjerë nuk e kishin përmendur kurrë PVGJ-në II. Ndërkohë që disa PFGJ ndiheshin plotësisht të mbështetur nga menaxhmenti, të tjerë ndiheshin plotësisht të pambështetur. Një anëtar i personelit të BE-së u shpreh se “varet shumë edhe nga Brukseli dhe personi që është i ngarkuar atje”. “Varet shumë nga përpjekjet dhe vullneti i tyre.”

Shkalla në të cilën menaxherët i kanë adresuar çështjet e barazisë gjinore së brendshmi dhe së jashtmi duket se është varur më shumë nga vullneti individual sesa nga praktika e institucionalizuar. Më tej, të dhënat lënë të kuptohet se aftësia udhëheqëse e dobët e disa menaxherëve në adresimin e pabarazive gjinore kontribuon në humbjen e interesit të disa anëtarë të personelit të BE-së për të ndërmarrë hapa drejt çuarjes më tutje të barazisë gjinore, sipas lidhjes që kjo ka me përgjegjësitë e tyre.

**Treguesi 2.3.4. Nr. i shpërblimeve apo vlerësimeve të ngjashme që i janë dorëzuar menaxhmentit/personelit të programit në pajtim me kriteret për të cilat është rënë dakord**

Ndërkohë që KE-ja, SHVJE-ja dhe SHA-të do të mund të ofronin çmime si nxitje për përmirësimin e procesit të arritjes së rezultateve lidhur me barazinë gjinore, në Raportin Vjetor për Zbatimin të vitit 2016 nuk u përmend asnjë provë për ndonjë çmim të tillë. Gjatë intervistave, nuk u përmendën raste çmimesh që ishin dhënë në BP. Nëse ishte identifikuar ndonjë kriter për të cilin ishte rënë dakord, DBE-të nuk kishin informacion për atë kriter.<sup>18</sup>

<sup>17</sup> KE, Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016, fq. iii.

<sup>18</sup> Kriteret e shpërblimit nuk u përcaktuan në “Shënimet udhëzuese për Planin e Veprimit Gjinor të BE-së për periudhën 2016-2020” të Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim, të vitit 2016.

**Mendoj se çështjet e barazisë gjinore nuk e zënë vendin kryesor në listën e prioriteteve politike dhe se çështjet gjinore duhet të integrohen në nivelin e politikave e jo vetëm në programim.”**

PFGJ, DBE

**Treguesi 2.3.3. Perceptimi i stafit të BE-së për performancën e menaxhimit të çështjeve gjinore**

KE-ja dhe SHVJE-ja duhet të matin progresin lidhur me këtë tregues përmes anketimeve vjetore të personelit, gjë që, mesa duket, ende nuk realizohet. Megjithatë, në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016 renditen disa shembuj të mënyrës se si PVGJ-ja II ka krijuar leadership më të dedikuar, gjë që dëshmohet nga përkrahja e analizave gjinore, trajnimet dhe angazhimi në “16 ditë aktivizëm kundër

### **Treguesi 2.4.1. Nëse sistemet raportuese korporative përfshijnë ndonjë vlerësim të qartë të performancës lidhur me objektivat e DPP-së si kërkesë**

Korniza e Rezultateve e BE-së (KRBE) përmban disa tregues të Qëllimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ) që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, por nuk duket se është përditësuar ende për të përfshirë objektivat e PVGJ-së II.<sup>19</sup> Prandaj, KE-ja dhe SHVJE-ja duket se nuk e kanë institucionalizuar ende raportimin për treguesit e PVGJ-së II, si pjesë e sistemit të raportimit korporativ. Pyetjet lidhur me zbatimin e PVGJ-së II janë bërë pjesë e Raportit për Menaxhimin e Veprimit të Jashtëm (RMVJ), edhe pse DBE-të i interpretuan disa pyetje në mënyra të ndryshme.<sup>20</sup> Mesa duket, RMVJ-ja nuk ka përmbajtur pyetje specifike lidhur me treguesit e PVGJ-së II. Në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016 diskutohet përparimi në këtë tregues vetëm në shtojcën 1, ku i referohet përparimit të SHA-ve në ndryshimin institucional.

### **Treguesi 2.4.4. Nr. i objektivave të DPP-së që DBE-të dhe SHA-të zgjedhin për të raportuar në nivel vendi**

KE-ja, SHVJE-ja dhe SHA-të duhet të përzgjedhin objektivat e PVGJ-së II për të raportuar çdo vit në nivelin e vendit. Tabela paraqet numrin e objektivave të PVGJ-së II, të përzgjedhura në secilin vend për vitin 2016. OSHCG-të nuk kishin informacion lidhur me këtë proces dhe pohojnë se me to nuk ishin zhvilluar konsultime për përzgjedhjen e objektivave të DPP-së, përveç Kosovës. Analizat gjinore të realizuara për secilin sektor mund të shërbejnë si të dhëna gjatë shqyrtimit të objektivave dhe veprimeve të PVGJ-së II, mbështetur në nevojat e identifikuara.

## **OBJEKTIVI I 3-TË. ALOKIMI I BURIMEVE TË MJAFTUESHME NGA ANA E INSTITUCIONEVE DHE SHTETEVE ANËTARE TË BE-SË PËR TË ZBATUAR ANGAZHIMET E BE-SË PËR POLITIKAT GJINORE**

### **Treguesi 3.1.1. Ndryshimi (rritja ose ulja) në fondet e dedikuara për përmirësimin e rezultateve për vajzat dhe gratë pas shqyrtimeve dhe SHAM-it të vitit 2017 (ose një dokumenti të barasvlershëm)**

KE-ja dhe SHA-të duhet të raportojnë për ndryshimet në fondet e dedikuara për përmirësimin e rezultateve për gratë dhe vajzat pas shqyrtimeve, sidomos pas shqyrtimit afatmesëm (SHAM) të vitit 2017. Nuk janë caktuar të dhëna kontrolluese apo synime.

Në përgjithësi, në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016 thuhet se ekziston një "perspektivë inkurajuese", duke iu referuar të dhënave të Shenjuesit Gjinor të OBEZH-it si burim të dhënash.<sup>21</sup> Është e paqartë se cilat vende përfituan dhe në çfarë mënyre nga veprimet e shënuara si G1 apo G2. Për më tepër, Shenjuesi Gjinor i OBEZH-it përfshin një mekanizëm të të gjitha veprimeve në drejtim të barazisë gjinore, i cili është shumë më i gjerë sesa financimi "i dedikuar" për gra dhe vajza. Në këtë mënyrë, ekziston një mospërputhje midis treguesit dhe burimit të të dhënave. Më tej, ndonëse financimet e alokuara mund të shërbejnë si tregues filleshtar i tërthortë, DBE-të mund të matin me saktësi vetëm "fondet e dedikuara për përmirësimin e rezultateve"

Vendi	Objektivat
Shqipëria	2
Bosnja dhe Hercegovina	10
Kosova	24
Maqedonia	0
Mali i Zi	3
Serbia	6
Gjithsej	45

menjëherë pas mbylljes së programeve dhe pasi të raportohen financimet reale që çuan në rezultate të verifikueshme në mënyrë objektive.

Në shtojcën e Konkluzioneve të Këshillit për PVGJ-në II sugjerohet që burim i të dhënave të jetë SHAM-i. Megjithatë, si pjesë e SHAM-it në vendet e BP-së, në Vlerësimin e Jashtëm të Instrumentit për Ndhimë Para Anëtarësimi II nuk u shqyrtuan financimet e dedikuara për gratë dhe vajzat.<sup>22</sup> As në vlerësimin e jashtëm të Programit të Përkrahjes së Shoqërisë Civile nuk u vlerësua shkalla

<sup>19</sup> Për më shumë informacione, shihni diskutimin në pjesën "Objektivi 5", treguesi 5.1.1.

<sup>20</sup> KE, Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016, fq. 26.

<sup>21</sup> Për informacione lidhur me Shenjuesin Gjinor të OBEZH-it, shihni treguesin 5.3.2. Ka edhe sfida të tjera.

<sup>22</sup> Shihni: Nicole Farnsworth dhe Iliriana Banjska nga RrGK-ja për Fondacionin "Kvinna till Kvinna", "Lexim gjinor i 'Vlerësimi të Jashtëm të Instrumentit për Ndhimë Para Anëtarësimi II', Prishtinë: 2017.



në të cilën gratë dhe vajzat kishin përfituar nga financimet.<sup>23</sup> Parlamenti Evropian ka deklaruar se “Ndien keqardhje [...] që vendimi i Komisionit nuk e adreson çështjen e zbatimit të integritimit gjinor në shqyrtimin e tij afatmesëm të KFA-së [Kornizës Financiare Afatmesme] dhe bën thirrje për veprime më specifike për adresimin e kësaj çështjeje”.<sup>24</sup> Prandaj, aktiviteti i planifikuar (3.1) i PVGJ-së II nuk është kryer. Tani BE-së i mungojnë të dhëna për planifikimin e dedikuar drejt përmirësimit të rezultateve për vajzat dhe gratë. RrGK-ja ka kërkuar të mbledhë të dhëna përmes këtij vlerësimi, por pengesat me sistemet ekzistuese elektronike të menaxhimit të të dhënave nënkuptojnë që DBE-të nuk mund të ofrojnë të dhëna specifike që kanë të bëjnë me këtë tregues. Mbështetur në vëzhgimin e tyre, pjesa më e madhe e DBE-ve vuri në dukje se që prej miratimit të PVGJ-së II nuk ka pasur asnjë ndryshim të konsiderueshëm në financime. Disa përfaqësues të DBE-ve vunë në dukje se rritja e financimeve për gratë dhe vajzat do të varej nga prioritetet e qeverisë përfituese dhe jo nga DBE-të.<sup>25</sup> Edhe SHA-të dhe donatorë të tjerë mund të kontribuojnë me financime për gratë, vajzat dhe/ose barazinë gjinore, e cila mund të ndikojë në fokusin dhe shkallën e financimeve të DBE-ve.<sup>26</sup> Të gjithë këta faktorë duhet të merren parasysh, ndërkohë që financimet duhet të koordinohen, duke u mbështetur në të dhënat e përmirësuara që kanë të bëjnë me këto financime të dedikuara.

Nga aspekti cilësor, DBE-të ofruan disa shembuj të programeve aktuale përmes të cilëve synohej të përmirësoheshin rezultatet për gratë dhe vajzat. Disa DBE iu referuan programit rajonal “Zbatimi i normave, Ndryshimi i mentalitetit” lidhur me luftën ndaj dhunës për shkaqe gjinore, të zbatuar nga UN Women. Në Mal të Zi, që prej vitit 2012, DBE-ja i ka caktuar fonde

Programit të saj Gjinor, i cili mund të vazhdojë si pjesë e programit të IPA-s për vitin 2018. Koha do të tregojë nëse këto investime i përmirësojnë “rezultatet për vajzat dhe gratë”.

### **Treguesi 3.2.1. Nr. i personelit, të ndarë sipas nivelit, të trajnuar për barazinë gjinore çdo vit dhe që raporton ndryshime në fushën ku punojnë**

Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016 nuk përmbante asnjë informacion lidhur me numrin e personelit të trajnuar për barazinë gjinore.<sup>27</sup> Megjithatë, trajnimet mund të mos jenë raportuar. Në Mal të Zi, përfaqësuesit e DBE-së përmendën një trajnim që ishte ofruar nga një ekspert i çështjeve gjinore. Në Maqedoni, personeli i operacioneve të DBE-së kishte marrë pjesë në trajnimin nga DP FMNZ-ja në qershor të vitit 2016. Disa anëtarë të personelit të DBE-së u trajnuan në Kosovë dhe Shqipëri. Personat me pozita të larta duket se janë trajnuar apo mentoruar më pak sesa personat e përfshirë në programim.

Përfaqësuesit e DBE-ve dukej se preferonin më shumë trajnimet praktike, të ndërlidhura drejtpërdrejt me programin e Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA) sesa “teoritë” apo leksionet. Punonjësit në një DBE-je nuk i shihnin

**Nëse dikush vjen nga Brukseli për të dhënë ndonjë trajnim, ai arrin të bëjë një ndryshim të vërtetë ndryshe nga ajo që do të arrija unë po të mbledhja kolegët për të predikuar barazinë gjinore”.**

PFJG

**Integrimi gjinor është artificial. Projektet tona janë për të mirën e të gjithëve.”**

ZYRTAR I BE-së

<sup>23</sup> “Prezantimi i gjetjeve të vlerësimit të Programit për Përkrahjen e Shoqërisë Civile”, Prishtinë, 27 tetor 2017.

<sup>24</sup> Komiteti për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore, “REPORT on EU funds for gender equality [RAPORT për fondet e BE-së për barazinë gjinore]”, (2016/2144(INI)), A8-0033/2017, 8 shkurt 2017, para. 71.

<sup>25</sup> Përgjegjësia që ka qeveria përfituese mbi proceset e IPA-s ndikon në shumë mënyra në zbatimin e PVGJ-së II (shihni 4.2.2).

<sup>26</sup> Koment nga një zyrtar i DBE-së (korrespondencë elektronike e dhjetorit të vitit 2017).

<sup>27</sup> KE, PVGJ-II, fq. 65.



**Nuk e kam kuptuar kurrë se si bëhet integrimi kuptimplotë gjinor, që të mos shënoj thjesht "x" brenda kutive."**

ZYRTAR I BE-së

me sy të mirë përvojat e mëparshme me trajnimet nga ekspertë që sillnin shembuj të integritit të çështjeve gjinore nga vendet afrikane, shembuj këta të cilët nuk kishin lidhje me kontekstin e BP-së. Megjithatë, një PFGJ vuri në dukje se kur ekspertët nga Brukseli apo ekspertët e huaj ofronin trajnime, punonjësit i dëgjonin me më shumë vëmendje sesa PFGJ-të.

Disa zyrtarë të DBE-së të të gjitha niveleve lanë të kuptohej se integrimi i çështjeve gjinore nuk ka vlerë, por është një "ushtrim sa për të plotësuar formularët". Këto pohime lënë të kuptohet se ata nuk janë trajnuar sa duhej lidhur me atë se çfarë përfshihet saktësisht në integrimin e çështjeve gjinore. Shprehitë politike në integrimin e çështjeve gjinore dukej se mungonin në të gjitha fazat e programimit të IPA-s: hartim, zbatim, monitorim dhe vlerësim.

Një sfidë tjetër që u vu re dhe që përbënte lajtmotiv për të gjitha delegacionet ishte qarkullimi i madh i personelit. Një zyrtar në një seksion bashkëpunimi pohoi se, "për shkak të qarkullimit të lartë të personelit, ne duhet të përpiqemi më shumë për ta integruar këtë te sektorët." Meqenëse personeli largohet rregullisht nga delegacionet, integrimi i çështjeve gjinore kërkon institucionalizim të mëtjshëm me anë të mostrave si dhe realizimin e trajnimeve hyrëse të detyrueshme lidhur me integrimin e çështjeve gjinore.

### Treguesi 3.2.2. Nr. i personave fokalë gjinorë (apo të të njëjtit nivel) të trajnuar çdo vit

Sipas Raportit Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, në vitin 2016 në trajnime morën pjesë nëntë PFGJ.<sup>28</sup> Këtu përfshihen PVGJ-të nga të gjitha vendet e BP-së. Gjatë intervistave, disa PVGJ iu referuan këtij trajnimi. Ata nënvizuan njohuritë dhe shprehitë e reja që kishin fituar nga zyrtarja e politikave për barazinë gjinore të KE-së, Karolina Vrethem, e cila kishte ofruar edhe mentorim përcjellës të rëndësishëm. Disa PFGJ përmendën si veçanërisht të dobishëm një ushtrim ndërveprues që kishte të bënte me barazinë gjinore në kuadrin e dokumenteve të programimit të IPA-s, i cili ishte realizuar nga një ekspert nga RrGK-ja, mbështetur në përvojën me përkrahjen ndaj Zyrës së BE-së (ZBE) në Kosovë.

### Treguesi 3.2.3. Integrimi i çështjeve gjinore në të gjitha trajnimet e ofruara

Ndonëse PVGJ-ja II parashikonte se çështjet gjinore do të integroheshin deri në vitin 2017 në të gjitha trajnimet e ofruara, intervistat lënë të kuptohet se kjo nuk ka ndodhur. Raporti Vjetor i Zbatimit të vitit 2016 nuk përmbante asnjë shembull të inkorporimit të integritit gjinor në trajnime në DP FMNZ.<sup>29</sup>

Vendi	2016.
Shqipëria	1
Bosnja dhe Hercegovina	2
Kosova	1
Maqedonia	0
Mali i Zi	0
Serbia	1
Gjithsej	5

### Treguesi 3.3.1. Nr. i Personave Fokalë Gjinorë (ose të të njëjtit nivel) që kanë 3 vjet ekspertizë në çështjet gjinore dhe/ose më shumë sesa 5 vjet përvojë teknike në një fushë të ndërlidhur

Sipas Raportit Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, pesë PFGJ në gjithë DP FMNZ-në (përtej BP-së) kanë tre vjet përvojë në çështjet gjinore dhe/ose më shumë sesa pesë vjet përvojë teknike në një fushë të ndërlidhur. Gjatë intervistave, disa PFGJ pohuan se ata nuk mendonin se kishin ekspertizë të mjaftueshme për të kryer rolin dhe zbatuar përgjegjësitë e tyre si PFGJ. Pjesa më e madhe e PFGJ-vë thanë se kishin pak ose aspak përvojë në ndonjë fushë të ndërlidhur me barazinë gjinore përpara se të ngarkoheshin me detyrën e PFGJ-së. Kjo lë të kuptohet se edhe personat që caktojnë PFGJ-të nuk e kuptonin nivelin e njohurive dhe ekspertizës që kërkohej për të përkrahur me efikasitet punën për integrimin e çështjeve gjinore.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty.

% e vendit	2016
Shqipëria	10-20
Bosnja dhe Hercegovina	30-40
Seksioni politik	5-10
Kosova	4-5
Maqedonia	15
Mali i Zi	20
Serbia	30-40
Gjithsej	16-21

### Treguesi 3.3.2. Nr. i përkrahjeve të vendeve të punës që përmbajnë barazi gjinore si fushë përgjegjësie, sipas vjetërsisë në punë

PVGJ-ja II parasheh se KE-ja, SHVJE-ja dhe SHA-të do ta përfshijnë çuarjen më tej të barazisë gjinore në grupin e përgjegjësive të zyrtarëve të të gjitha niveleve, duke e përfshirë atë në përkrahjet e vendeve të tyre të punës. Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016 nuk përmbante asnjë informatë lidhur me numrin e përkrahjeve të vendeve të punës ku barazia gjinore përbënte fushë përgjegjësie në DP FMNZ.<sup>30</sup> Megjithatë, kjo mund të ketë ndodhur pjesërisht për shkak të faktit se përkrahjet e vendeve të punës hartohen dhe miratohen në Bruksel.<sup>31</sup>

Me përjashtim të një rasti, në vendet e BP-së, përkrahja e vendit të punës të PFGJ-ve nuk është përditësuar për të përfshirë përgjegjësitë ekzistuese të PFGJ-së. Të mbetur me përgjegjësi të papërcaktuara qartë.

PFGJ-ve shpeshherë u është dashur t'u japin përparësi detyrave të tjera ndaj punës së tyre si PFGJ, gjë që ka bërë që ata të kishin më pak kohë në dispozicion për t'u marrë me çështjet dhe detyrat specifike gjinore.

### Treguesi 3.3.2. Nr. i përkrahjeve të vendeve të punës që përmbajnë barazi gjinore si fushë përgjegjësie, sipas vjetërsisë në punë

PVGJ-ja II parasheh se KE-ja, SHVJE-ja dhe SHA-të do ta përfshijnë çuarjen më tej të barazisë gjinore në grupin e përgjegjësive të zyrtarëve të të gjitha niveleve, duke e përfshirë atë në përkrahjet e vendeve të tyre të punës. Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016 nuk përmbante asnjë informatë lidhur me numrin e përkrahjeve të vendeve të punës ku barazia gjinore përbënte fushë përgjegjësie në DP FMNZ.<sup>30</sup> Megjithatë, kjo mund të ketë ndodhur pjesërisht për shkak të faktit se përkrahjet e vendeve të punës hartohen dhe miratohen në Bruksel.<sup>31</sup> Me përjashtim të një rasti, në vendet e BP-së, përkrahja e vendit të punës të PFGJ-ve nuk është përditësuar për të përfshirë përgjegjësitë ekzistuese të PFGJ-së. Të mbetur me përgjegjësi të papërcaktuara qartë, PFGJ-ve shpeshherë u është dashur t'u japin përparësi detyrave të tjera ndaj punës së tyre si PFGJ, gjë që ka bërë që ata të kishin më pak kohë në dispozicion për t'u marrë me çështjet dhe detyrat specifike gjinore. Në Udhëzuesin e PVGJ-së II thuhet se: "Koha që i kushton Personi Fokal Gjitor funksionit të tij/saj duhet të pasqyrohet si duhet në përkrahjet e vendit të punës me qëllim që të garantohet alokimi i duhur i orëve të punës për detyrat (të paktën 40-60% të kohës së një jave normale pune)."<sup>32</sup> Mesatarisht, PVGJ-të në DBE-të e BP-së mendonin se kalojnë vetëm midis 16 dhe 21% të kohës së tyre me detyrat e PVGJ-së.

PFGJ-të vënë në dukje se përditësimi i përkrahjeve të punës të atyre vetë dhe të anëtarëve të tjerë të personelit, në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, do të kontribuonte në përmirësimin e vëmendjes ndaj çuarjes përpara të barazisë gjinore. Edhe integrimi i përgjegjësive për promovimin e barazisë gjinore në kuadrin e përkrahjeve të vendeve të punës të ambasadorëve, udhëheqësve të bashkëpunimit dhe menaxherëve të projekteve të sektorëve<sup>33</sup> ka rëndësi thelbësore, me qëllim që përgjegjësia për ngritjen e problematikave të barazisë gjinore brenda dialogut të politikave të jetë e qartë.<sup>34</sup>

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> Intervista me RrGK-në.

<sup>32</sup> DP BNZH, "Guidance note on the EU Gender Action Plan 2016 – 2020 for DEVCO HQ and EUD operational staff [Shënim udhëzues për Planin e Veprimit Gjitor të BE-së 2016-2020 për ZQ-në e BNZH-së dhe personelin operativ të DBE-ve]", fq. 47. Ndonëse ky shënim udhëzues ka të bëjë me DP BNZH-në, mendohet se edhe për DP FMNZ-në ka një shënim udhëzues të ngjashëm.

<sup>33</sup> Në këtë punim, termi "menaxher projekti" përdoret për t'u referuar edhe menaxherëve të detyrave dhe menaxherëve të programit menadhere/ke.

<sup>34</sup> Shihni treguesin 1.1.2.

## OBJEKTIVI I 4-TË. PËRDORIMI I PROVAVE TË SHUMTA GJINORE SI MJET INFORMUES PËR TË GJITHA SHPENZIMET E JASHTME TË BE-SË, PROGRAMIMIN DHE POLITIKËBËRJEN

Vendi	Nr. i programeve me analizë gjinore	Nr. i përgj. i programeve	% e prog. ku përdoret analiza gjinore
Shqipëria	1	N/A	N/A
Bosnja dhe Hercegovina	32	N/A	N/A
Kosova	15	15	100%
Maqedonia <sup>35</sup>	N/A	N/A	N/A
Mali i Zi	4	4	100%
Serbia	1	9	11%
Gjithsej	53	28	

### Treguesi 4.1.1. Nr. i programeve tematikë, dypalësh dhe rajonale vjetorë, ku përdoret analiza gjinore si burim të dhënash për hartimin e tyre

Në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016 thuhet se 29 programe në DP FMNZ përfshinin analizën gjinore për nxjerrjen e të dhënave që shërbejnë për hartimin e tyre.<sup>36</sup> Këtu përfshiheshin programet nga.

Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia.<sup>37</sup> Megjithatë, meqenëse numri i përgjithshëm i programeve nuk është raportuar, nuk dihet përqindja e të gjitha programeve që përfshinin analizën gjinore. Ndoshta, një përqindje e të gjitha programeve do të ishte një tregues më i saktë sesa numri për këtë tregues, meqenëse do të ilustronte më mirë se sa programe kanë përfshirë analizën gjinore. Mostra e raportimit duket se e ka identifikuar këtë mangësi; është shtuar një radhë për të identifikuar përqindjen "në raport me të gjitha programet e reja të hartuara në vitin 2016".<sup>38</sup> Megjithatë, nuk ka të dhëna të disponueshme për DP FMNZ-në apo specifiku për BP-në.

Që prej vitit 2017, analizat e përgjithshme gjinore ishin kryer në të gjitha vendet për të ndihmuar në identifikimin e objektivave dhe treguesve të PVGJ-së II në nivel vendi. Megjithatë, vetëm disa vende kishin kryer analiza gjinore ku ishin shqyrtuar me hollësi sektorë të caktuar. Përgjigjja e zakonshme nga menaxherët e projekteve në DBE ishte se për të ofruar të dhëna gjatë hartimit të veprimeve specifike nuk ishte përdorur asnjë analizë gjinore. Disa prej tyre vunë në dukje mungesën e të dhënave statistikore gjinore që kishin të bënin me sektorë të caktuar.

### Treguesi 4.1.2. Nr. i vlerësimeve të programeve për vit, të cilët përfshijnë vlerësimin e ndikimit të gratë dhe vajzat

Në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016 nuk thuhet nëse ndonjë vend i BP-së ka përfshirë në ndonjë vlerësim programi të kryer gjatë vitit 2016 ndonjë vlerësim të ndikimit të gratë dhe vajzat.

### Treguesi 4.2.1. Nëse proceset e brendshme të shqyrtimit metodologjik kryhen për të integruar çështjet gjinore në mekanizmat e sigurimit të cilësisë (p.sh. për KE-në: Grupi i Mbështetjes së Cilësisë, etj.)

Edhe pse shqyrtimi i cilësisë duhet të përfshijë shqyrtimin gjinor, kjo nuk është kryer ende, ndonëse njëri prej res-

pondentëve vuri në dukje se në këtë drejtim ishin duke bërë përpjekje.

Vendi	# i DV-ve të	Nr. i përgj. i DV-ve	% e DV-ve të rishiku
Shqipëria	1	N/A	N/A
Bosnja dhe Hercegovina	32	N/A	N/A
Kosova	15 <sup>39</sup>	15	100%
Maqedonia <sup>35</sup>	N/A	N/A	N/A
Mali i Zi	4	4	100%
Serbia	1	9	11%
Gjithsej	53	28	

### Treguesi 4.2.2. Nr. i dokumenteve të reja të veprimit (apo dokumenteve të të njëjtit nivel) që janë komentuar dhe më pas rishikuar se mos çështjet gjinore nuk janë marrë parasysh si duhet

Sipas Raportit Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, mbetet ende "shumë për

<sup>35</sup> Përfaqësuesit e DBE-ve raportonin se analiza gjinore e projekteve të programimit të IPA-s I ishte ndërmarrë nga integrimi i Projektit të Binjakëzimit të IPA-s për Barazinë Gjinore (korrespondencë elektronike, dhjetor 2017). Megjithatë, numri i saktë i programeve nuk është dhënë.

<sup>36</sup> KE, Raporti Vjetor i Zbatimit të vitit 2016, fq. 66.

<sup>37</sup> Po aty, fq. 55

<sup>38</sup> Po aty, fq. 66

<sup>39</sup> Janë rishikuar dhe për to janë dhënë komente. Deri tani nuk ka të dhëna lidhur me atë nëse ndryshimet e sugjeruara janë miratuar.



t'u bërë për të integruar analizën gjinore në procesin e plotë të planifikimit dhe hartimit të Dokumenteve të Veprimit" (DV).<sup>40</sup> Aneksi i raportit duket se pohon se për vetëm pesë DV ishin dhënë komente në DP FMNZ. Megjithatë, intervistat e RrGK-së lënë të kuptohet se në vendet e DB-së janë shqyrtuar më shumë sesa pesë DV.

Ndryshe nga DP BNZH-ja, DP FMNZ-ja nuk ka kontraktuar asistencë për përkrahjen e shqyrtimit të të gjitha DV-ve të reja nga pikëpamja gjinore. Meqenëse DP FMNZ-ja nuk ka ndonjë qendër të shkëlqesisë tematike që merret me barazinë gjinore dhe që do të mund të merret përsipër detyrat e sigurimit të cilësisë, kjo detyrë, mesa duket, duhej të kryhej nga pozicioni i krijuar së fundmi i asistentit të politikave – Barazia gjinore brenda DP FMNZ-së. Megjithatë, detyra e shqyrtimit të të gjitha DV-ve të reja nga perspektiva gjinore është tepër e madhe për një person të vetëm, po të marrim parasysh afatet kohore për përgatitjen e këtyre dokumenteve. Gjithashtu, edhe njohuritë për kontekste specifike ndoshta do të nevojiteshin për t'i ofruar të dhëna çfarëdo lloj shqyrtimi të nevojshëm. Përfaqësuesit e DBE-ve prireshin të mos përmendnin marrjen e komenteve nga DP FMNZ-ja lidhur me DV-të draft, të cilat kishin të bënin me barazinë gjinore.

Në nivelin e delegacionit, DBE-të kanë ndërmarrë qasje të ndryshme në drejtim të integritimit më të mirë të çështjeve gjinore në kuadrin e programeve të IPA-s. Në Kosovë, Zyra e BE-së ka kontraktuar RrGK-në që prej vitit 2015 për të ofruar ekspertizë dhe për të ndihmuar në integrimin e çështjeve gjinore në programimin e IPA-s (shihni studimin e rastit). Organizata "UN Women" në Serbi hartoi një trajnim me titull "Integrimi i çështjeve gjinore në IPA", të cilin organizata "UN Women" në Shqipëri e kopjoi dhe e zhvilloi më tej me përkrahjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim.<sup>41</sup> Këto tre ndërhyrje të ndryshme kishin të bënin me punën me nëpunësit civilë në sektorë të ndryshëm, MKBGJ, ekspertë të çështjeve gjinore dhe menaxherë projektsh në DBE dhe i kanë ndihmuar ata për të çuar më tej integrimin e çështjeve gjinore në procesin e programimit të IPA-s. Në Bosnje dhe Hercegovinë, PFGJ-ja i DBE-së ka rishikuar programet e IPA-s në të cilët integrohen çështjet gjinore. Po ashtu, në Maqedoni, PFGJ-ja me menaxherin e programit të DBE-së në seksionin e bashkëpunimit kanë ndërmarrë shqyrtimin e DV-ve të IPA-s nga pikëpamja e barazisë gjinore. Në Malin e Zi, DBE-ja ka kontraktuar një ekspert të huaj për të lehtësuar integrimin e çështjeve gjinore. Në këtë mënyrë, DBE-të kanë kërkuar të integrojnë çështjet gjinore në procesin e programimit të IPA-s, edhe pse qasjet që ato kanë ndjekur kanë qenë të ndryshme.

Ndonëse ekspertët e çështjeve gjinore kanë propozuar që disa DV të rishikohen, mesa duket jo të gjitha janë "rishikuar më pas". Të intervistuarit identifikuan disa faktorë që ndikonin në këtë. Së pari, disa menaxherë projektsh kishin vullnet apo njohuri të kufizuara ose nuk e kuptonin sa duhej rëndësinë e integritimit të çështjeve gjinore, sidomos në sektorë që gabimisht janë menduar si "neutral nga pikëpamja gjinore" siç është sektori i energjetikës apo ujësjellësit. Kështu, ata jo gjithmonë e kuptonin se si të integronin çështjet gjinore në doku-

## STUDIM RASTI:

### KONTRAKTIMI I EKSPERTËVE TË OSHCG-VE

E kontraktuar nga Zyra e BE-së në Kosovë që prej vitit 2015, RrGK, një OSHCG lokale, i ka ofruar përkrahje teknike Zyrës së BE-së, Ministrisë për Integrimin Evropian, Agjencisë për Barazinë Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit dhe zyrtarëve të barazisë gjinore (ZBGJ) për integrimin e çështjeve gjinore në kuadrin e programeve të IPA-s. Si pjesë e funksionit të saj "help-desk", RrGK ka mbështetur edhe hartimin e PVGJ-së së ZBE-së për periudhën 2016-2020 në Kosovë. Vlera e shtuar e kontraktimit të një OSHCG-je lokale është se këto shpeshherë kanë lidhje lokale, njohuri, shprehje gjuhësore dhe qasje në grupe të ndryshme të synuara. Për më tepër, ato janë efikase dhe investimet në vend janë të qëndrueshme. OSHCG-të motivohen nga misioni i tyre, duke vazhduar kështu të monitorojnë ndryshimet dhe të avokojnë për to edhe pas mbarimit të kontratës.

<sup>40</sup> KE, Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016, fq. 4.

<sup>41</sup> Korrespondencë elektronike me një zyrtar të DBE-së në Shqipëri, dhjetor 2017.

mentet përkatëse. Së dyti dhe lidhur me të parën, zyrtarët e Brukselit raportohet se ndonjëherë kanë zhbërë veprimet e integritit të çështjeve gjinore, të ndërmarra më përpara në nivel delegacioni, sepse, mesa duket, këto veprime përmbanin ato që ata i konsiderojnë si hollësi të parëndësishme.<sup>42</sup>

Sfida e tretë që vihej në dukje nga menaxherët e projekteve ishte se palët homologe qeveritare nuk i pranonin gjithmonë ndryshimet e propozuara. Për shembull, në Kosovë, një menaxher projektsh kishte nxitur një ministri të linjës që të përfshinte në dokumentet e programimit të IPA-s perspektivën gjinore. Megjithatë, Ministria nuk e konsideroi këtë si prioritet dhe i shpërfilli rekomandimet e BE-së. Në pjesën më të madhe të vendeve të BP-së, qeveritë përfituese duhet të kenë përgjegjësi për programimin e IPA-s dhe ato janë përgjegjëse për planifikimin e programimit në harmoni me strategjitë ekzistuese sektoriale.

Lajtmotiv ishte fakti se kjo paraqet një sfidë themelore në zbatimin e PVGJ-së II: DBE-të mund t'i këshillojnë qeveritë, por nuk mund t'i detyrojnë ato të miratojnë rekomandimet. Mungesa e përgjegjësisë së DBE-ve për DV-të kontribuon në ngurimin në radhët e zyrtarëve të DBE-ve që të inkurajojnë qeveritë përfituese për të adresuar pabarazitë gjinore dhe për t'i bërë objektivat tematike të PVGJ-së II pjesë të programimit. Megjithatë, kjo lë të kuptohet se edhe DBE-të prirën ta trajtojnë çuarjen më tej të barazisë gjinore si një të drejtë themelore "opsionale" dhe jo si një kërkesë themelore që është po aq e rëndësishme sa edhe reformat e tjera.

Një sfidë e katërt institucionale themelore ndaj përparimit në këtë tregues është se çështjet gjinore trajtohen kryesisht dhe ndonjëherë vetëm brenda seksionit të çështjeve "ndërsektoriale" të mostrës së DV-ve. Prandaj, barazia gjinore nuk integrohet përmes pjesëve të tjera të DV-ve, siç janë analiza e situatës, logjika e ndërhyrjes dhe tabelat e treguesve. Megjithatë, në vjeshtën e vitit 2017, zyrtari i politikave i DP FMNZ-së për barazi gjinore/këshilltari për çështje gjinore ndërmori hapa për ta adresuar këtë çështje, mbështetur edhe në rekomandimet specifike që kishte ofruar RrGK-ja lidhur me mënyrën se si duhet të integrohet perspektiva gjinore në pjesët e tjera të DV-së. Ekzistojnë mundësitë për ndryshimin e mostrave të DV-ve, me qëllim që të bëhet e kërkueshme ofrimi i informatave që kanë të bëjnë me gjininë në të gjitha pjesët e DV-së, në kuadrin e ndryshimeve të vazhdueshme në mostrat që kanë të bëjnë me OPSYS-in, sistemin e ri elektronik të menaxhimit të informatave, i cili është duke u zhvilluar aktualisht. Pa kërkesat për përfshirjen në DV të objektivave, të dhënave kontrolluese dhe synimeve të informuara përmes analizave gjinore, zbatuesit nuk do të jenë përgjegjës për raportimin lidhur me përparimin drejt çuarjes përpara të barazisë gjinore. Për këtë arsye, caktimi i këtyre kërkesave brenda mostrave është themelor për të siguruar llogaridhënien në arritjen e rezultateve në drejtim të barazisë gjinore dhe për raportet e mëvonshme për rezultatet.

I paqartë është fakti që për këtë tregues nuk janë caktuar të dhëna kontrolluese apo synime. Aktualisht, rritja e numrit të DV-ve për të cilat jepen komente dhe që rishikohen do të jetë pozitive sepse tregon se ekzistojnë mekanizmat e sigurimit të cilësisë.<sup>43</sup> Sidoqoftë, një e metë e mundshme e këtij treguesi është se në vitet e mëvonshme, ngritja e kapaciteteve, teorikisht, duhet të përmirësojë integritimin gjinor brenda DV-ve. Kjo do të çonte në rënien e numrit të DV-ve për të cilat kërkohen komente dhe shqyrtime, gjë që do të ishte pozitive.

Prandaj, ndoshta një tregues më i mirë për aktivitetin dhe objektivin përkatës do të ishte ajo nëse ekzistojnë mekanizmat e standardizuar të sigurimit të cilësisë, ku ekspertët e çështjeve gjinore të shqyrtonin të gjitha DV-të nga perspektiva gjinore. Për shembull, në lidhje me këtë, Agjencia Austriake për Zhvillim ka një praktikë të mirë, e cila siguron që çdo DV t'i nënshtrohet rishikimit nga ekspertët të çështjeve gjinore, që përfituesit të dokumentet përfundimtare të projekteve për të trajtuar komentet e dhëna nga ekspertët e çështjeve gjinore përpara nënshkrimit të kontratës, dhe që raportimi i rregullt të ofrojë reagime të përditësuara lidhur me çështjet e ngritura nga eksperti i çështjeve gjinore.

**Treguesi 4.3.1. % e programeve ku përdoren gjetjet e konsultimeve me Mekanizmat Kombëtarë të Barazisë Gjinore, OSHC-të, organizatat e grave, për të nxjerrë të dhëna që përdoren gjatë hartimit të veprimit**  
Në përgjithësi, në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016 të KE-së thuhet se ekziston "njëfarë konsultimi" me

<sup>42</sup> Intervista me RrGK-në.

<sup>43</sup> Siç parashihet në aktivitetin 4.2, "Të krijohen procese të sigurimit të cilësisë për dokumentet e projektit, dhe të vihet në pikëpyetje miratimi i shpenzimeve kudo që çështjet gjinore nuk merren parasysh në mënyrë të mjaftueshme".



**Me OSHCG-të dhe MKBGJ-të organizohen konsultime, por ndonjëherë më duket sikur nuk e kanë idenë se për çfarë po flasim. Ata vijnë me të njëjtat pika. Gjithmonë të njëjtat dyshime.”**

ZYRTAR I BE-së

MKBGJ-të dhe OSHC-të, “edhe për problematika të barazisë gjinore, edhe pse jo të formalizuara”. Për shembull, raporti vë në dukje konsultimet që Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (IEDDNJ) bën thirrje për propozime.<sup>44</sup> Shembujt e ofruar iu referohen konsultimeve që kanë të bëjnë me financimet për OSHC-të. Nuk janë dhënë shembuj lidhur me programet për sektorë specifikë dhe konsultimet që janë realizuar për të dëgjuar pikëpamjet dhe nevojat e grave dhe burrave në raport me këto programe. As Raporti Vjetor i Zbatimit nuk përmban të dhëna të qarta lidhur me këtë tregues.

Raporti duket se lë të kuptohet se pesë DBE dhe DP FMNZ-ja kanë përfshirë organizatat e Mbrojtëseve të të Drejtave të Grave “dhe/ose OSHC që punojnë për të drejtat e grave gjatë konsultimeve me shoqërinë civile”. Versioni i rishikuar i këtij treguesi në Raport nuk përmban të dhëna të mjaftueshme lidhur me shkallën në të cilën janë konsultuar, përkatësisht, MKBGJ-të, OSHC-të dhe organizatat e grave, për të nxjerrë informata dhe për t’i përdorur këto për DV-të. Treguesi i rishikuar ka disa probleme. Së pari, ai e zgjeron në mënyrë të konsiderueshme domethënien e treguesit për të përfshirë, mesa duket, çdo lloj konsultimi që është mbajtur me shoqërinë civile dhe që jo domosdoshmërisht kanë të bëjnë me programe të caktuara. Së dyti, me treguesin e ri shpërfillen plotësisht MKBGJ-të, si institucione të rëndësishme qeveritare. Së treti, me këtë tregues ngatërrohet terminologjia duke futur një term të ri, organizatat e “mbrojtësve të të drejtave të grave”, në treguesin fillestar, term ky që i referohet vetëm organizatave të grave. Këta dy terma nuk janë sinonime. Së katërti, për të llogaritur me saktësi përqindjen e programeve në nivelin vendor, racional dhe ndërkombëtar, një përqindje nuk është e mjaftueshme: është e nevojshme të ketë edhe numra realë.

Në vendet e BP-së, RrGK-ja nuk mundi të identifikonte përqindjen e saktë të programeve të hartuara duke përdorur gjetjet e dala nga konsultimet e zhvilluara me MKBGJ-të, OSHC-të dhe organizatat e grave. Kjo kishte të bënte me faktin se DBE-të nuk kanë sisteme elektronike për gjurmimin e asaj nëse konsultime të tilla janë organizuar për programe specifike. Lidhur veçanërisht me programimin sektorial (DV-të), të pakta kanë qenë DBE-të që ishin konsultuar me MKBGJ-të. Në Maqedoni dhe Kosovë, MKBGJ-të raportonin se ministritë dhe departamentet përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të IPA-s merren me këto procese dhe nuk zhvillojnë konsultime me to.<sup>45</sup> Ndonëse RrGK-ja ka kërkuar t’i përfshijë MKBGJ-të në Kosovë, ministritë e linjës i kanë rezistuar kësaj përfshirjeje, duke mos e parë dobinë apo qëllimin e përfshirjes së tyre. Në Malin e Zi, menaxherët e projekteve pohonin se nuk zhvillojnë konsultime me MKBGJ-të, duke vënë në dukje se kishin pasiguri lidhur me këto organe, edhe pse PFGJ-ja pohonte se MKBGJ-të janë pjesë e procesit dhe që kanë të bëjnë kryesisht me të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve. Në Bosnje dhe Hercegovinë, MKBGJ-ja në nivelin kombëtar raportohet se është përfshirë, edhe pse MKBGJ-ja në Banja Lukë kishte shqyrtuar vetëm disa dokumente të IPA-s.

Vendi	MKBGJ-të e konsultuara	OSHC-të E konsultuara	OSHCG-të e konsultuara
Legjenda: ~ = disi;	p = po	x = jo	
Shqipëria	x	x	x
Bosnja dhe Hercegovina	x	x	x
Kosova	x	x	~
Maqedonia	x	x	x
Mali i Zi	~	p	x
Serbia	~	~	x

Për shkak të riorganizimit të qeverisë, Shqipëria nuk kishte krijuar asnjë MKBGJ. Në Serbi, MKBGJ-ja deklaronte se kishte bashkëpunuar ngushtë me organizatën “UN Women” për organizimin e integritit të çështjeve gjinore në DV. Për sa u takon konsultimeve me shoqërinë publike lidhur me programimin, vendet e BP-së kanë

<sup>44</sup> fq. 12.

<sup>45</sup> Intervista me RrGK-në.

përvoja të ndryshme. Mali i Zi e ka sistematizuar pjesëmarrjen e OSHC-ve:

OSHC-të aplikonin dhe qeveria përzgjidhte OSHC-të që dukeshin më me përvojë në sektorë të caktuar, për të marrë pjesë rregullisht në grupet sektoriale të punës. Megjithatë, nuk ishte përfshirë asnjë OSHCG, sidomos kur merret parasysh mungesa e njohurive për faktin se çështjet gjinore duhet të integrohen brenda sektorëve. Në të njëjtën mënyrë, në Maqedoni, grupet sektoriale të punës i kanë ftuar OSHC-të, duke përfshirë edhe OSHC-të që merren me barazinë gjinore, në konsultimet për programet e IPA-s, edhe pse kjo, siç raportohet, “nuk ka funksionuar edhe aq normalisht”, meqenëse grupet e punës nuk takoheshin në mënyrë sistematike dhe OSHC-të nuk ftoheshin të merrnin pjesë në çdo mbledhje.<sup>46</sup> OSHCG-të në të gjitha vendet e BP-së pohonin se kishin pak ose aspak informacione lidhur me procesin e anëtarësimit në BE. Ato nuk kishin marrë pjesë në asnjë diskutim për ofrimin e të dhënave për planifikimin e programeve specifike të BE-së. Asnjë prej 38 OSHCG-ve të intervistuar nuk përmendi se me to ishin bërë konsultime lidhur me programe specifike. I vetmi përjashtim ishte RrGK, e cila ishte përfshirë në kryerjen e shqyrtimeve dhe dhënien e komenteve lidhur me të gjitha DV-të për Zyrën e BE-së në Kosovë.

DBE-të kanë dhënë disa shkaqe lidhur me arsyet se pse nuk i kanë organizuar këto konsultime. Së pari, disa zyrtarë të DBE-ve përsëritnin pohimin e përmendur më sipër se qeveritë përfituese, dhe jo DBE-të, duhet të marrin përgjegjësi për organizimin e konsultimeve publike. Për më tepër, zyrtarët e DBE-ve vinin në dukje faktin se DV-të duhet të dalin drejtpërdrejt nga Dokumentet e Planifikimit Sektorial, të cilat duhet të mbështeten në strategjitë ekzistuese shtetërore, të cilat kanë përfshirë konsultimet e mëparshme me publikun. Thënë ndryshme, qeveritë do të duhej të kishin kryer prej kohësh konsultime me publikun lidhur me programet. Për këto arsye, sipas tyre, kjo nuk do të duhej të ishte përgjegjësi e DBE-së. OSHCG-të dhe pjesa më e madhe e MKBGJ-ve vinin në dukje se proceseve të konsultimit me publikun lidhur me strategjitë qeveritare kishin prirje t'u mungonte cilësia e duhur. Edhe një zyrtar i BE-së vuri në dukje se: “shumë strategji kombëtare nuk përmbajnë përgjegjësinë gjinore dhe ndjeshmërinë ndaj çështjeve gjinore, tregues gjinorë, etj.” Zyrtari tha se këto mangësi ishin përgjegjësi e aktorëve kombëtarë dhe jo e DBE-së. Një arsyetim i tillë i bën të paqartë rolin dhe përgjegjësinë e DBE-së në nxitjen e qeverive përfituese për adresimin e mangësive në lidhje me të drejtat themelore të rëndësishme për anëtarësimin në BE dhe, sidomos, me programet e financuara nga BE-ja. DBE-të kanë pushet të inkurajojnë fuqimisht qeveritë për të përmirësuar mangësitë në drejtim të çuarjes përpara të barazisë gjinore, duke u kërkuar, ndër të tjerash, që qeveritë të konsultohen me përkatësisht me MKBGJ-të, OSHC-të dhe OSHCG-të gjatë proceseve të planifikimit të programeve të financuara nga BE-ja. Në të vërtetë, inkurajimi i qeverisë për të organizuar këto konsultime ndoshta do të ishte në kuadrin e frymës së këtij treguesi të PVGJ-së II.

Së dyti, zyrtarët e DBE-së dhe ata të qeverisë thoshin se afatet e shkurtra kohore për përgatitjen e programeve, sidomos DV-ve, e bënin të pamundur organizimin e konsultimeve me publikun. Një lajtmotiv i tretë i përfaqësuesve të DBE-ve, sidomos në Shqipëri dhe Serbi, ishte se MKBGJ-të dhe OSHCG-të nuk kanë kapacitete, burime njerëzore, përvojë dhe njohuri për të kontribuar me të dhëna të dobishme që do të shërbenin gjatë hartimit të programeve.<sup>47</sup> Nga ana tjetër, MKBGJ-të dhe OSHCG-të pohonin se mungojnë nismat nga DBE-të për zhvillimin e konsultimeve me to, sidomos lidhur me programimin, zbatimin dhe vlerësimin e IPA-s.<sup>48</sup>

Si përfundim, të dhënat e mbledhura përmes këtij vlerësimi lënë të kuptohet se DBE-të nuk janë konsultuar mjaftueshëm apo sistematikisht me MKBGJ-të, OSHC-të dhe organizatat e grave për të mbledhur të dhënat dhe komentet e tyre lidhur me ndryshimet e politikave apo hartimin e programeve të IPA-s.

## **OBJEKTIVI I 5-TË. MATJA E REZULTATEVE PËR GRATË DHE VAJZAT DHE ALOKIMI I BURIMEVE PËR GJURMIMIN SISTEMATIK TË ECURISË**

### **Treguesi 5.1.1. Statusi i rezultateve të monitorimit të treguesve të ndjeshmërisë gjinore**

Në vitin 2015, KE-ja miratoi Kornizën e parë të Rezultateve (KRBE).<sup>49</sup> Në KRBE “gjinia” përmendet 16 herë dhe

<sup>46</sup> Përfaqësues i DBE-së (korrespondencë, dhjetor 2017)

<sup>47</sup> Intervista me RrGK-në.

<sup>48</sup> Në veçanti, për vlerësimin e Jashtëm të programimit të IPA-s konsultime ishin zhvilluar vetëm me një OSHCG (shihni Farnsworth dhe Banjska, 2017).

përmban tre tregues që kanë të bëjnë me çuarjen përpara të barazisë gjinore, si dhe tregues specifikë për gratë. Këtu përfshihen:

- 1) Përpjesëtimi i vendeve që mbajnë gratë në parlamentet kombëtare (në harmoni me treguesin 5.5 të QZHQ-së së OKB-së)
- 2) Përqindja e grave të moshës 20 deri 24 vjeçare, të cilat ishin martuar përpara se të mbushnin 15/18 vjeç (QZHQ 5.3)
- 3) Përpjesëtimi i nismave për bashkëpunim dhe zhvillim, të financuara nga BE-ja, përmes të cilave promovohet barazia gjinore dhe fuqizimi i grave
- 4) Numri i grave që përdorin ndonjë metodë kundër shtatzënisë, me përkrahjen e BE-së.<sup>50</sup>

Gratë përmenden në tregues të tjerë të QZHQ-së, të cilët përkohet me treguesit e KRBE-së. Megjithatë, në të vërtetë treguesit e KRBE-së nuk kërkojnë tekstualisht që të dhënat të ndahen sipas gjinisë, përveç një rasti.<sup>51</sup> Meqenëse KRBE-ja ishte miratuar disa muaj përpara PVGJ-së II, ajo nuk përmban disa tregues të caktuar të PVGJ-së II.

Prandaj, PVGJ-ja II caktoi një fazë, pra që deri në fund të vitit 2016, nëse paraqitej nevoja, kornizat e rezultateve korporative të rishikoheshin për të përfshirë "treguesit e ndjeshmërisë gjinore dhe shenjën e ndarjes së të dhënave sipas gjinisë, ndarje kjo në harmoni me treguesit e QZHQ-së."<sup>52</sup> Faza e dytë e paraparë ishte që në fund të vitit 2016, "të gjitha rezultatet e mbledhura krahas atyre që janë përfshirë në kornizat e rezultateve korporative të ndaheshin sipas gjinisë aty ku ishte e përshtatshme".

Edhe pse Raporti Vjetor i Zbatimit të vitit 2016 përmban të dhëna lidhur me këtë tregues të PVGJ-së II nga Korniza e Rezultateve të SHA-ve, në të nuk ka raportime lidhur me përparimin e KE-së. KRBE-ja nuk është përditësuar ende, por me sa duket është planifikuar të përditësohet në vitin 2017.<sup>53</sup> Ndërkohë, KRBE-ja përmendet në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016 lidhur me disa tregues të PVGJ-së.<sup>54</sup> Megjithatë, edhe një herë, shumë tregues nuk kërkojnë tekstualisht që të dhënat të ndahen sipas moshës apo gjinisë (shihni shtojcën 4). Fakti që Plani i Veprimit Gjinor nuk kërkon të dhëna të ndara sipas gjinisë për disa tregues është mjaft problematik. Gjithashtu, ka të ngjarë që kjo të kontribuojë në pasaktësi në raportimet gjatë viteve të ardhshme për PVGJ-në II, meqenëse DBE-të mund të raportojnë vetëm numra të përgjithshëm dhe jo të dhëna të ndara sipas gjinisë. Nuk mund të merret e mirëqenë që zyrtarët e DBE-ve, vendet përfituese dhe kontraktorët do të raportojnë me vetë iniciativën e tyre të dhëna të ndara sipas gjinisë, pa iu kërkuar që ta bëjnë këtë. Duhet të kërkohet që të dhënat për secilin tregues të PVGJ-së II të ndahen sipas gjinisë.

### **Treguesi 5.1.2. % e rezultateve të ndara sipas gjinisë, aty ku është e përshtatshme, në Kornizën (Kornizat) e Rezultateve**

Lidhur me këtë, meqenëse KRBE-ja nuk është përditësuar ende, nuk ka pasur ndonjë rritje të përqindjes së rezultateve të ndara sipas gjinisë.

### **Treguesi 5.1.3. Statusi i treguesve të PPK-së krahasuar me QZHQ-të**

Edhe pse kjo nuk thuhet tekstualisht në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, treguesit e PVGJ-së II janë rishikuar duke u krahasuar me treguesit e QZHQ-së. Në shtojcën 2 të Raportit Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, ka referenca të rregullta tek treguesit e QZHQ-së, meqenëse këta tregues përkohet me treguesit e PVGJ-së II.

<sup>49</sup> Dokumenti i Punës për Personelin i Komisionit, "Launching the EU International Cooperation and Development Results Framework [Lansimi i rezultateve për bashkëpunimin dhe zhvillimin ndërkombëtar të BE-së]", SWD (2015) 80 përfundimtar, Bruksel: 26 mars 2015, marrë nga: [https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/swd-2015-80-f1-staff-working-paper-v3-p1-805238\\_en\\_0.pdf](https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/swd-2015-80-f1-staff-working-paper-v3-p1-805238_en_0.pdf).

<sup>50</sup> Shihni përkatësisht fq. 21, 29, dhe 26.

<sup>51</sup> Treguesi 8: "Numri i grave dhe burrave që kanë zotërim të sigurt të tokës me përkrahje të BE-së" (fq. 24).

<sup>52</sup> Konkluzionet e Këshillit, fq. 14.

<sup>53</sup> Shihni: [capacity4dev.eu](https://europa.eu/capacity4dev/eu-rfi), "EU Results Framework Indicators [Treguesit e Kornizës të Rezultateve të BE-së]", në adresën: <https://europa.eu/capacity4dev/eu-rfi>, parë për herë të fundit më 27 nëntor 2017, ku thuhet se: "Korniza e Rezultateve të BE-së do të shqyrtohet gjatë vitit 2017 për të pasqyruar Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe prioritetet e reja zhvillimore të BE-së, të parashtruara në Konsensusin e ri Evropian për Zhvillimin, të miratuar kohëve të fundit."

<sup>54</sup> Shihni shtojcën 2, tabela 5.

### Treguesi 5.3.1. Nr. i arsytimit për pikët G0 në Shënjesin Gjnor të OBEZH-it

Shënjesi Gjnor i Komitetit të Asistencës Zhvillimore (KAZH) të OBEZH-it është “një shënjes përmes të cilit projektet vlerësohen me pikë mbështetur në shkallën e rëndësisë që ka dimensionin e tyre gjnor”.<sup>55</sup> Çdo projekt duhet të marrë një Shënjes Gjnor, duke përdorur sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave të BE-së: Sistemin e Përbashkët Informativ për Marrëdhëniet e Jashtme (SPIMJ). Projektet përmes të cilave synohet kryesisht të kontribuohet në barazinë gjnore dhe fuqizimin e grave në një nivel të përgjithshëm objektiv vlerësohen me pikën G2 në Shënjesin Gjnor Projektet përmes të cilave synohet në mënyrë të konsiderueshme të nxitet barazia gjnore dhe/ose fuqizimi i grave vlerësohen me pikën G1. Projektet që “nuk kanë potencial të brendshëm për të ndikuar në barazinë gjnore” vlerësohen me pikën G0. Për këtë tregues të PVGJ-së II kërkohet që të gjitha projektet e vlerësuar me pikën G0 të japin arsytimit për këtë pikë.

Në Raportin Vjetor të Vlerësimit të vitit 2016 thuhet se katër programe të SHA-ve raportojnë arsytimit për pikën G0 të Shënjesit Gjnor të OBEZH-it në vitin 2016.<sup>56</sup> Megjithatë, mungonin të dhënat nga DBE-të. Një sfidë që u vu në dukje nga PFGJ-të në vendet e BP-së është se sistemi SPIMJ u mundëson personave që hyjnë te të dhënat të anashkalojnë Shënjesin Gjnor duke e lënë opsionin në pozicionin e tij të parapërzgjedhur: G0. Përdoruesi mund të kalojë në faqen tjetër në SPIMJ pa iu kërkuar të ofrojë arsytimit për pikën G0. Meqenëse kjo pyetje shpeshherë është anashkalluar gjatë hedhjes së të dhënave, rrallëherë ka ndodhur që të jenë shënuar arsytimit.

DP FMNZ <sup>60</sup>	Angazhimi për vitin 2016 (EUR)	% e angazhimit të përgj. në 2016	Disburimi në vitin 2016 (EUR)	% e disbursimit të përgjith. në 2016
G0	1,655,450	36,00	1,906,797	62,72
G1	2,871,925	62,42	1,076,457	35,41
G2	72,250	1,57	56,911	1,87
Gjithsej	4,600,625		3,040,166	

### Treguesi 5.3.2. % e programeve të reja që vlerësohen me pikën G1 apo G2

Mbështetur në qëllimet e PVGJ-së I, PVGJ-ja II cakton një synim ambicion që 85% e të gjitha

programeve të reja të marrin pikën G1 apo G2 në Shënjesin Gjnor deri në vitin 2020. Të dhënat kontrolluese përbënin mesatarisht 47% në të gjitha programet e BE-së në vitin 2015.<sup>57</sup>

Në vitin 2016, KE-ja raportonte se përqindja e të gjitha programeve me pikë G1 apo G2 ishte rritur në 57.75%. Më konkretisht, 56.6% (47 nga 83) e programeve të reja të vlerësuar nga DP FMNZ-ja si “kryesisht apo në mënyrë të konsiderueshme”, synojnë të “promovojnë barazinë gjnore dhe/ose fuqizimin e grave” (G1 ose G2).<sup>58</sup> Prandaj, 43.4% e veprimeve të reja të DP FMNZ-së ishin vlerësuar me G0. Kjo lë të kuptohet se ka pasur përmirësime në krahasim me vitin 2015, kur DP FMNZ-ja klasifikoi 75% të fondeve të angazhuara si G0, 22% si G1 dhe 3% si G2.<sup>59</sup> KE-ja e përshëndeti rritjen e përdorimit të vlerësimit G1 dhe G2 si shenjë që tregon se është rritur numri i programeve që i kanë barazinë gjnore dhe fuqizimin e grave si objektiva kryesore të tyre.

Në aspektin e financimeve të angazhuara, siç ilustron në tabelë, DP FMNZ-ja i rriti financimet e angazhuara të vlerësuar me G1 (22%) apo G2 (3%) nga 25% që ishte në vitin 2015 në 64% të fondeve në vitin 2016 (62% G1, 2% G2). Për sa u takon disbursimeve, DP FMNZ-ja i rriti fondet e disbursuar për projektet e vlerësuar me notën G1 dhe G2 nga 18% (16% G1, 2% G2) që ishte në vitin 2015 në 37% (35% G1, 2% G2) në vitin 2016. Të dhënat specifike për secilin vend në BP nuk janë ofruar ndërkohë që disa zyrtarë të BE-së vunë në dukje se të dhënat e disponueshme nuk ishin të besueshme<sup>61</sup>.

Disa respondentë nga DBE-të pohuan se Shënjesi Gjnor ishte thjesht një ushtrim “sa për të plotësuar kutitë” ose “ushtrim akademik” që “nuk përfaqëson ndikimin e vërtet në realitet”. Ata nuk e kuptonin qëllimin e përdorimit të

<sup>55</sup> Konkluzionet e Këshillit, fq. 12. Për më shumë informata, shihni: Shënjesi i politikave të KAZH-it të OBEZH-it për barazinë gjnore dhe fuqizimin e grave, marrë nga: <http://www.oecd.org/dac/gender-development/dac-gender-equality-marker.htm>.

<sup>56</sup> Raporti Vjetor i Zbatimit të vitit 2016, fq. 70.

<sup>57</sup> Po aty, fq. 5

<sup>58</sup> Po aty, fq. 4

<sup>59</sup> Po aty, fq. 102

<sup>60</sup> Po aty, fq. 7 Shumat janë rrumbullakosur në euron më të afërt nga RrGK.

<sup>61</sup> Zyrtarët vunë në dukje se të dhënat e disponueshme aktualisht ishin mjaft të dyshimta (korrespondencë elektronike, dhjetor 2017)

Shënjesit Gjinator. Një tjetër arsye e zakonshme që u dha për përdorimin e rrallë të Shënjesit Gjinator ishte se menaxherëve të projekteve u mungonin informacionet lidhur me kuptimin e Shënjesit Gjinator dhe mënyrën se si përdoret ai. Ata nuk mendonin se kishin ekspertizën e duhur për të vlerësuar programe nga pikëpamja gjinore. U përmendën edhe vështirësi që kishin të bënin me infrastrukturën e shënjimit dhe programe të tjera sektoriale që nuk përfshinin “aspektin social” në mënyrë të rregullt. Një PFGJ përmendi subjektivitetin që lidhet me Shënjesin Gjinator, duke vënë në dukje se “është artificial” dhe se “varet shumë nga vlerësimi personal”.<sup>62</sup> Në Serbi, respondentët thanë se sistemi i kodimit do të ndryshonte së shpejti (do të kalonte në OPSYS), prandaj tani ata nuk shihnin ndonjë arsye për kodimin e këtij informacioni në sistemin e vjetor (SPIMJ).

Në këtë mënyrë, përdorimi i Shënjesit Gjinator ka pasur disa mangësi. Së pari, udhëzimet fillestare të dhëna dhe gjuha e përdorur, ku fokusi është përqendruar te objektivat domethënëse (G1) ose ato të përgjithshme (G2), i ka penguar shumë menaxherët e projekteve të përdorin Shënjesin Gjinator sepse e interpretonin atë si diçka që nuk kishte të bënte me punën e tyre. Kjo ndodh sepse mostrat e DV-ve udhëzojnë në mënyrë specifike që programet të kenë vetëm një objektiv të përgjithshëm dhe, mundësisht, vetëm një objektiv specifik. Nga pikëpamja e terminologjisë së kornizave logjike, menaxherët e projekteve e kanë të vështirë të arsyetojnë përfshirjen në DV të një objektivi tjetër specifik apo të përgjithshëm për barazinë gjinore, i cili do të përqendrohej, për shembull, te zhvillimi i infrastrukturës apo energjive të rinovueshme. Ndonëse ata kanë mundësi të integrojnë çështjet gjinore në aktivitete, rezultatet e pritshme dhe/ose menaxhimi i projekteve, në dukje, gjuha e “objektivave”, e cila përdoret në Shënjesin Gjinator, lë të kuptohet se as një integrim i tillë nuk do të vlerësohej me pikën G1 apo G2. Për këtë arsye, gjuha fillestare shpjeguese e Shënjesit Gjinator ndoshta i ka ngatërruar koduesit meqenëse dukej e pazbatueshme. Është problematik fakti se në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, shpeshherë përdoret këmbëveshëm termi “integrim gjinor” në 85% të programeve me termin e synimit të “shënjimit/vlerësimit” të 85% të projekteve me pikën G1 dhe G2; kjo është ngatërruese sepse projektet mund të integrohen nga ana gjinore pa arritur të plotësojnë kriteret fillestare për t’u vlerësuar me pikën G1. Në dhjetor të vitit 2016, OBEZH-i publikoi një doracak për Shënjesin e Politikave për Barazi Gjinore të KAZH-it të OBEZH-it, i cili përmbante udhëzime që synonin të qartësonin këtë çështje.<sup>63</sup> Megjithatë, edhe në udhëzues përdoret gjuha e objektivave, e cila ka të ngjarë të vazhdojë të shkaktojë paqartësi në radhët e menaxherëve të projekteve dhe shteteve përfituese.

Së dyti, dhe lidhur me të parën, njohuritë dhe ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm ka të ngjarë të ketë kontribuar në keqraportime për Shënjesin Gjinator. Deri më sot, shënuesi është përdorur kryesisht sipas interpretimeve subjektive.

Ndonëse ky doracak i ri ka synuar të qartësojë kuptimin e secilës pikë, fakti që pak menaxherët të rinj projektuesh e kanë marrë apo lexuar atë nënkupton që shënjimi/vlerësimi ndoshta vazhdon të mbetet subjektiv. Më tej, Udhëzuesi është disi i gjatë dhe kërkon ca njohuri dhe ekspertizë themelore në integrimin e çështjeve gjinore, të cilat i kanë fare pak prej personave që kodojnë të dhënat. Kjo kontribuon në pasaktësinë e të dhënave, të cilat nuk mund të përdoren për të matur me saktësi përparimin në PVGJ-në II.

Së treti, sfida e përmendur më sipër që qeveritë përfituese hartojnë pjesën më të madhe të DV-ve dhe jo DBE-të, vazhdon të mbetet një pengesë që DBE-të të sigurojnë që qeveritë të integrojnë çështjet gjinore në kuadrin e programeve. Ndonëse DBE-të mund të ushtrojnë presion politik, ato mbështeten te vendet përfituese për të pranuar propozimet e tyre.

Së katërti, një problem teknik me Shënjesin Gjinator është se kur programet kodohen si G1 apo G2, shuma e përgjithshme e tyre priret të konsiderohet si kontribut për barazinë gjinore. Kjo është keqinformuese, sidomos për programet e shënjura me G1, të cilat mund të alokojnë vetëm një pjesë të shpenzimeve të përgjithshme për barazinë gjinore. Për këto arsye, shuma e përgjithshme që raportohet se është dhënë si kontribut në drejtim të çuarjes përpara të barazisë gjinore mund të mos jetë e saktë.

## **OBJEKTIVI I 6-TË. NXITJA E PARTNERITETEVE MIDIS BE-SË DHE PALËVE TË INTERESUARA PËR TË NGRITUR KAPACITETET KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE**

<sup>62</sup> Intervistë e RrGK-së.

<sup>63</sup> OECD-DAC Network on Gender Equality (GENDERNET), “Handbook on the OECD-DAC Gender Equality Policy Marker [Doracak për Shënjesin e Politikave për Barazi Gjinore të KAZH-it të OBEZH-it]”, marrë nga: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/Handbook-OECD-DAC-Gender-Equality-Policy-Marker.pdf>. Shih fq. 10-11.

Në përgjithësi, DBE-të kanë ndërmarrë fare pak iniciativa për të krijuar partneritete midis BE-së dhe palëve të interesit për të ngritur kapacitetet kombëtare për barazinë gjinore, sikurse tregohet nga përparimi minimal që është bërë në treguesit e mëposhtëm. Vihet re se PVGJ-ja II nuk ka paraparë nismat për të krijuar partneritete apo për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të OSHCG-ve si palë kyçe të interesit në drejtim të çuarjes përpara të kapaciteteve kombëtare për barazinë gjinore, gjë që ndoshta paraqet një mangësi të PVGJ-së.

#### **Treguesi 6.1.1. Nr. i projekteve të hulumtimit, të bashkë inancuara nga BE-ja (DBE/SHA) për problematika të ndërlidhura me çështjet gjinore<sup>64</sup>**

#### **Treguesi 6.1.2. Nr. i programeve të mbështetur nga BE-ja që raportojnë përmirësime në cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave statistikore të ndara sipas gjinisë/specifike për çështjet gjinore**

Këta tregues janë në harmoni me aktivitetin e parashikuar të PVGJ-së II për të: “6.1. Përkrahur hulumtimin dhe kapacitetet për analiza të pavarura të instituteve kombëtare të statistikave, akademive dhe OSHC-ve, duke përfshirë analizën makroekonomike, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe stereotipat gjinorë”. Mungesa e të dhënave të sakta, duke përfshirë të dhënat kontrolluese për matjen e përparimit në treguesit e PVGJ-së II, ishte një problem “lajtmotiv” që vihej re në intervista. Në këtë mënyrë, ekzistojnë disa mundësi që DBE-të të përkrahin zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese në vendet e BP-së. Megjithatë, krahas analizave gjinore që kërkohen nga PVGJ-ja II, DBE-të nuk kishin shumë shembuj hulumtueshëm të ndërlidhura me barazinë gjinore dhe që ato kishin financuar. Ekzistojnë mundësi që mekanizma të tjerë të financimit të BE-së dhe SHA-të, sidomos Suedia, të mund të kenë financuar hulumtimet në vendet e BP-së, edhe pse shqyrtimi i këtyre kontributeve dilte jashtë fushëveprimit të këtij vlerësimi.

Duke marrë parasysh numrin e vogël të projekteve të njohura të financuara nga BE-ja për hulumtime në fushën e barazisë gjinore, kuptohet që të pakta kanë qenë edhe përmirësimet e raportuara lidhur me cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave. Kjo ka të bëjë edhe me faktin se ishte ende herët për të raportuar për rezultatet e programeve që rridhnin nga investimet e nisura nga PVGJ-ja II. Përrjashtim bënte Serbia, e cila u bë vendi i parë joanëtar i BE-së që hartoi Indeksin e Barazisë Gjinore të BE-së.<sup>65</sup> Edhe pse vendet e tjera ndërmorën hapa në këtë drejtim, ato nuk e përfunduan indeksin, përmes të cilit do t'i kishin bërë këto të dhëna më të disponueshme.

Vendi	Vendi Mekanizmi i koordinimit?
Shqipëria	Jo
Bosnja dhe Hercegovina	Po
Kosovë	Po
Maqedonia	Po
Mali i Zi	Po
Serbia	Po
Gjithsej	5

#### **Treguesi 6.2.1. Nr. i vendeve partnere që kanë mekanizma të koordinimit gjinor, ku përfshihen aktorë (ndërkombëtarë) që punojnë në nivel lokal**

Sipas Raportit Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, 13 vende të DP FMNZ-së kanë ngritur mekanizma të koordinimit gjinor, edhe pse vendndodhjet e tyre nuk janë renditur.<sup>66</sup> Intervistat lënë të kuptohet se këto organe nuk ekzistojnë në Shqipëri. Në Bosnje dhe Hercegovinë, përfaqësuesit e DBE-së dhe PFGJ-ja në Ministrinë e Integritimit Evropian përmendën një organ koordinues i cili supozohej se monitoronte zbatimin e PVGJ-së II: DBE-ja ka inkurajuar MKBGJ-në

të udhëheqë këtë organ. Në Malin e Zi, Departamenti për Barazi Gjinore pranë Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve, është përgjegjës për të gjitha koordinimet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, duke përfshirë këtu koordinimin me pikat fokale gjinore në ministri dhe komuna. Krahas kësaj, Komiteti Parlamentar për Barazinë Gjinore për Koordinim Politikash dhe Këshilli Kombëtar për Barazi Gjinore përfshijnë anëtarë nga shoqëria civile dhe zyrtarë publikë. Megjithatë, përfaqësuesit e shoqërisë civile u shprehën se në praktikë këta mekanizma rrallëherë zbatohen. Në Maqedoni, një organ koordinimi ndërsektorial merret me problematikat e barazisë gjinore së bashku me përfaqësues nga të gjitha ministrinë, shoqëria civile dhe partnerët socialë.<sup>67</sup> Në Kosovë, Agjencia për Barazi Gjinore së bashku me Ministrinë për Integritimin Evropian, zyrtarisht përgjegjëse për koordinimin e donatorëve, filloi të koordinonte punën për barazinë gjinore duke organizuar një takim në fillim të vitit 2017.

<sup>64</sup> KE, Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016, fq. 57. Kjo tabelë përfshin vetëm DBE-të dhe jo SHA-të.

<sup>65</sup> Po aty, fq. 58 Suedia ka financuar përmirësimin e të dhënave në Shqipëri, Serbi dhe Kosovë; Austria ka ofruar përkrahje në Shqipëri.

<sup>66</sup> Po aty, fq. 59



Në përgjithësi, ndërkohë që, në aspektin teorik, pjesa më e madhe e vendeve kanë mekanizma koordinimi gjinor, intervistat lënë të kuptohet se, në aspektin cilësor, ata jo gjithmonë funksionojnë mirë. Mekanizmat priren të jenë më shumë në trajtën e takimeve ad hoc sesa në trajtën e atyre sistematike dhe konsultimeve. Ndonjëherë, takimet e nëngrupeve që kishin të bënin me problematika specifike funksiononin më mirë.

Vendi	Programi për MKBGJ-të	Nr. i sektorëve që përfshijnë MKBGJ-të
Shqipëria	Po	1 <sup>68</sup>
Bosnja dhe Hercegovina	Jo	1
Kosovë	Po	0?
Maqedonia	Jo	0?
Crna Gora	Po	0
Mali i Zi	Po	1
Gjithsej	4	3

### Treguesit 6.3.1. Nr. i programeve për MKBGJ-të, të përkrahura nga BE-ja dhe G.3.2 Nr. i programeve sektoriale që punojnë me MKBGJ-të

Këta tregues matin shkallën në të cilën DBE-të përkrahin MKBGJ-të në çuarjen më tej të kapaciteteve të tyre dhe përfshijnë MKBGJ-të në programim respektivisht. Në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016 thuhet se DBE-të janë duke përkrahur programet për MKBGJ-të në Shqipëri,

Kosovë dhe Serbi.<sup>69</sup> Veç kësaj, SHA-të në vendet e BP-së raportonin se përkrahnin MKBGJ-të në Shqipëri (Suedia) dhe Kosovë (Suedia dhe Gjermania). Në raport thuhet edhe se MKBGJ-të janë përfshirë në një program sektorial në Shqipëri, me përkrahjen e BE-së. Ndërkohë, Suedia ka përkrahur një program sektorial që punon me MKBGJ-të në Serbi.

Vendi	Media
Shqipëria	0
Bosnja dhe Hercegovina	3
Kosovë	0
Maqedonia	0
Mali i Zi	0
Serbia	1
Gjithsej	4

### Treguesi 6.4.1. Nr. i projekteve që rritin ndërgjegjësimin e medias lokale dhe kombëtare për problematikat gjinore në vendet partnere dhe që përkrahin nga BE-ja

Sipas Raportit Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, 10 DBE në Evropë dhe në Azinë Qendrore janë duke përkrahur rritjen e ndërgjegjësimin të medias lidhur me problematikat gjinore, edhe pse nuk përmenden emrat e vendeve. Përfaqësuesit e DBE-ve në përgjithësi linin të kuptohet se në lidhje me punën me medien për problematikat që kanë të bëjnë me çështjet gjinore është bërë fare pak. Që prej hyrjes në fuqi të PVGJ-së II, DBE-të duket se nuk kanë investu-

ar për ngritjen e kapaciteteve të medieve lokale për raportimin cilësor rreth problematikave që kanë të bëjnë me çështjet gjinore apo për ngritjen e problematikave të barazisë gjinore në nivel lokal. Një shembull i jashtëzakonshëm dhe i qartë i mënyrës se sitë angazhohet media për rritjen e ndërgjegjësimin rreth çështjeve gjinore gjatë ngritjes së kapacitetit të tyre për rritjen e ndërgjegjësimin, u gjet në Serbi: një projekt në Vojvodinë, i financuar nga IEDDNJ-ja, trajnoi stafin mediatik për problematikat e çështjeve gjinore dhe më pas i vuri ata të raportonin për tema të ndërlidhura. PFGJ-ja sugjeroi që qytetet e tjera në Serbi mund ta imitonin këtë nismë të suksesshme

## OBJEKTIVI I 18-TË. ORGANIZATAT E GRAVE DHE OSHC-TË E TJERA DHE MBROJTËSIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT QË PUNOJNË PËR BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN DHE TË DREJTAT E GRAVE DHE VAJZAVE TË JENË NË GJENDJE TË PUNOJNË PA PENGESA DHE TË MBROHEN NGA LIGJI

### Treguesi 18.1. Nr. i mbrojtësve të të drejtave të njeriut të grave, të cilët kanë marrë përkrahje nga BE-ja (KRBE)

Në prioritetin tematik të PVGJ-së II, të ndërlidhur me të drejtat politike dhe civile: Ngritja e zërit dhe Pjesëmarrja, qëllimi është që: "BE-ja të vazhdojë të kontribuojë, në një mënyrë të matshme, në rritjen e veprimeve, dëgjimin e zërit dhe pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në jetën sociale, ekonomike, politike dhe civile". Ndonëse në përgjithësi, në këtë vlerësim nuk shqyrtoam prioritetet tematike të PVGJ-së II, një tregues nga Objektivi 18 është përmendur si përjashtim, duke marrë parasysh marrëdhëniet e rëndësishme midis këtij treguesi dhe realizimit të disa treguesve të tjerë në PVGJ-në

<sup>67</sup> Intervistë e RrGK-së me MKBGJ-në në Maqedoni.

<sup>68</sup> KE, Raporti Vjetor i Zbatimit të vitit 2016, fq. 61.

<sup>69</sup> Po aty, fq. 60

II, sipas prioritetit të ndryshimit të kulturës institucionale. Me fjalë të tjera, një aktivitet i parashikuar që kontribuon në arritjen e Objektivit 18 është “përkrahja e pjesëmarrjes së organizatave të grave si agjente të llogaridhënies në proceset buxhetore, legjislative dhe ato të politikëbërjes në të gjitha nivelet”, duke kontribuar kështu në treguesin 18.1.

Edhe pse ky tregues lidhet me KRBE-në, ai është ndoshta një mekanizëm i dobët për matjen e përkrahjes ndaj pjesëmarrjes së OSHCG-ve, sepse nuk përqendrohet te mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave. Përqendrimi tek individët dhe jo tek organizatat apo lëvizjet, e individualizon aktivizmin për të drejtat e grave, duke shpërfillur mjediset dhe bazat e përshtatshme e të rëndësishme mbi të cilat është ngritur një aktivizëm i tillë. Përqendrimi te gratë si individë nuk arrin të masë me saktësi arritjen e objektivit, njëloj siç nuk mat as përkrahjen ndaj organizatave të grave apo OSHC-ve të tjera që punojnë për çuarjen më tej të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Gjithashtu, matja e numrit të mbrojtësve të të drejtave të njeriut të grave, të përkrahura nga BE-ja, paraqet disa sfida nga pikëpamja metodologjike.

Në Raportin Vjetor të Zbatimit të vitit 2016, thuhet se vetëm dy DBE në gjithë Evropën dhe Azinë Qendrore kishin deklaruar se planifikonin të përkrahnin mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave, si pjesë e përpjekjeve të tyre për zbatimin e PVGJ-së II.<sup>70</sup> Asnjë nga këto DBE nuk ishte nga BP-ja. Megjithatë, Kosova propozoi një tregues të ri e të tërthortë: “numrin e OSHC-ve, të përkrahura nga BE-ja, që punojnë drejt çuarjes përpara të barazisë gjinore”.

Përveç sfidave të përgjithshme metodologjike të përmendura më sipër të cilat lidhen me këtë tregues, pamjaftueshmëria e burimeve për OSHCG-të mund të pengojë aftësinë e tyre për të marrë pjesë në proceset e anëtarësimit në BE, duke përfshirë konsultimet dhe punën avokuese që ka të bëjë me barazinë gjinore, të skicuar në pjesë të tjera të PVGJ-së II. OSHCG-të janë partnerë kyç për DBE-të për të siguruar që çështjet gjinore të integrohen në qasjen e parë themelore; për të siguruar përqendrimin te çështjet gjinore gjatë dialogut politik; dhe për të siguruar integrimin e çështjeve gjinore dhe ekspertizës gjinore që ka të bëjë me përkrahjen financiare që u jep BE-ja vendeve përfituese. Për të mbështetur DBE-të në zbatimin e objektivave të PVGJ-së II në këto fusha, OSHCG-ve u duhen burime, kryesisht burime njerëzore, që i përgjigjen këtij objektiv. Të “kesh mundësi të punosh lirshëm” lidhet me praninë e burimeve të mjaftueshme për të punuar, gjë që nuk matet në mënyrë të mjaftueshme përmes këtij treguesi.

Ndërkohë, OSHCG-të në të gjithë rajonin raportonin se mungonin burimet, gjë që pengonte punën e tyre dhe kufizonte kohën që mund të kalonin për të monitoruar dhe avokuar për barazinë gjinore në raport me proceset e anëtarësimit në BE. Krahas kësaj, OSHCG-ve në disa vende të BP-së u është pakësuar hapësira.<sup>71</sup> Në mjediset politike shtypëse, edhe përkrahja politike nga DBE-të (PVGJ II, objektivi 1) në mbrojtjen e të drejtave të OSHCG-ve për të operuar, si dhe çështjet e ngritura nga OSHCG-të, përbëjnë një formë thelbësore të përkrahjes.

---

## ÇËSHTJE TË TJERA DHE MËSIMET E NXJERRA PËR PVGJ-NË III

---

Edhe pse nuk kishte të bënte me ndonjë objektiv dhe tregues specifik në kuadrin e PVGJ-së II, gjatë procesit të vlerësimit u vunë re disa çështje të tjera. Së pari, PVGJ-ja III duhet, idealisht, të programohet duke u mbështetur në PVGJ-në II dhe të përkojë me programe të tjera. Duke marrë parasysh afatet kohore të cikleve të programimit, duhet kohë që të shihet ndikimi i PVGJ-së II në raport me prioritetet tematike. Së dyti, në PVGJ-në II, DBE-të duhet të integrojnë çështjet gjinore në programe, por pjesa më e madhe e programeve, siç u përmend, hartohen nga shtetet përfituese. PVGJ-ja III duhet të adresojë më qartë çështjen e roleve dhe përgjegjësisë të DBE-ve për çuarjen më tej të agjendës së barazisë gjinore në mjedise të tilla si ai i BP-së. Së treti, disa tregues në PVGJ II, ndonëse nuk u shtjelluan në këtë punim, janë problematike dhe duhet të rishikohen.<sup>72</sup> Së katërti, dhe lidhur me të tjerat, ndërkohë që PVGJ-ja II cakton treguesit, fare pak kanë

<sup>70</sup> Po aty, fq. 17, 88.

<sup>71</sup> Shihni: Kvinna till Kvinna Foundation, “Building resilience – counteracting the shrinking space for women’s rights [Krijimi i aftësisë rimëkëmbëse - kundërveprimi ndaj tkurrjes së hapësirave të të drejtave të grave]”, 2017.

<sup>72</sup> Shihni shtojcën 4.

të dhëna krahasuese apo synime. Kjo, pas njëfarë kohe, e bën të vështirë matjen e përparimit. Veç kësaj, mungesa e synimeve specifike pengon llogaridhënien e aktorëve të BE-së për të arritur rezultatet e pritura.

Së pesti, dhe më gjerësisht, për një plan veprimi gjinor, PVGJ-ja II i kushton jashtëzakonisht fare pak rëndësi burrave, djemve dhe marrëdhënieve gjinore. Përvoja në BP lë të kuptohet se kuadrimi i barazisë gjinore vetëm te gratë mund të çojë në keqkuptime lidhur me atë se çfarë nënkupton barazia gjinore dhe në rezistencë nga ana e burrave, duke minuar kështu përpjekjet për çuarjen më tej të barazisë gjinore.

---

## REKOMANDIME

---

### PËR SHËRBIMET E VEPRIMIT TË JASHTËM EVROPIAN

- Të emërohen më shumë gra si udhëheqëse të misionëve të BE-së kur të ketë shpallje për pozicione të lira (Objektivi 2).
- Të kryhen analiza gjinore për të nxjerrë informata që do të përdoren gjatë angazhimit në dialog politik, duke siguruar që problematikat e rëndësishme që kanë të bëjnë me barazinë gjinore të bëhen pjesë e të gjitha diskutimeve politike në mënyrën e duhur. Për të nxjerrë të dhëna për analizat gjinore, të zhvillohen takime të rregullta me OSHCG-të për të mbledhur informacione të rëndësishme dhe brenda kohës së arsyeshme lidhur me problematikat prioritare të barazisë gjinore në vend dhe në rajon.
- Të sigurohet që takimet me OSHCG-të të zhvillohen gjatë orarit normal të punës, duke respektuar kohën e aktivistëve për të drejtat e grave, si dhe me mbulim mediatik, aty ku është e përshtatshme. Këto veprime do t'u japin përkrrahje të rëndësishme politike OSHCG-ve, duke iu vënë në dukje zyrtarëve të qeverisë që BE-ja e konsideron të rëndësishëm dialogun me OSHCG-të dhe çuarjen përpara të barazisë gjinore një prioritet.

### PËR KOMISIONIN EVROPIAN

- Të informohen udhëheqësit e delegacioneve dhe zyrtarët politikë për përgjegjësitë që ata kanë sipas PVGJ-së II, duke përfshirë rëndësinë e ngritjes së problematikave të ndërlidhura me çështjet gjinore gjatë dialogut politik. Të bashkëpunohet me SHVJE-në për përgatitjen e udhëzuesve, duke përfshirë udhëzimet specifike për sektorët, lidhur me rëndësinë që ka integrimi i çështjeve gjinore në dialogun politik dhe mënyrën se si mund të realizohet kjo, udhëzues këta që duhet të shpërndahen në ZQ dhe DBE. Të nxiten udhëheqësit e delegacioneve që të udhëheqin duke qenë vetë shembull. Të merret parasysh garantimi që të paktën një këshilltar politik në çdo DBE të ketë ekspertizë në çështjet gjinore dhe të jetë në gjendje të këshillojë rregullisht udhëheqësit e delegacioneve lidhur me mënyrën se si të integrohet perspektiva gjinore në rastet e ndryshme të dialogut politik (objektivi 1).
- DP BNZH-ja, si organ përgjegjës për PVGJ-në II, duhet të rishikojë treguesit dhe burimet e të dhënave për përmirësimin e saktësisë, duke përfshirë "financimet e dedikuara" për gratë dhe vajzat dhe OSHCG-të (objektivi 3).
- Të përmirësohen sistemet e menaxhimit të të dhënave, duke përfshirë kërkesën për raportim lidhur me financimet e dedikuara për gratë dhe vajzat brenda sistemit të ri OPSYS (objektivi 3).
- Të sigurohet që i gjithë personeli i DBE-ve në të gjitha nivelet të kryejë trajnimin e detyrueshëm për barazinë gjinore, duke përfshirë trajnimin në shprehje praktike lidhur me integrimin e çështjeve gjinore të ndërlidhura me rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse. Me DP-në e Burimeve Njerëzore, të merret parasysh krijimi i një softueri trajnimi në internet, i cili duhet të jetë ndërveprues dhe i detyrueshëm, dhe që mund të implementohet te të gjitha delegacionet dhe të bëhet i domosdoshëm për të gjithë zyrtarët (objektivi 3). Trajnimi elektronik duhet

të jetë praktik dhe jo teorik dhe të përmbajë shembuj specifikë nga DV-të nga sektorë të ndryshëm. Ai duhet të përmbajë shumë ushtrime praktike të ndërlidhura me integrimin gjinor në programim. Ky trajnim duhet të mbështetet me mentorime që u përshtaten përgjegjësive të personelit të BE-së, dhe që jepen sipas rastit nga pika fokale gjinore dhe ekspertët e kontraktuar. Të përmirësohen sistemet e gjurmimit të trajnimeve të ofruara, p.sh. përmes sistemit të trajnimit "EU Learn".

- Të alokohen burime njerëzore të përshtatshme dhe të dedikuara për zbatimin e PVGJ-së II, duke përfshirë si ekspertët e çështjeve gjinore në Bruksel, ashtu edhe DBE-të (objektivi 3).
- Të përditësohen urgjentisht përshkrimet e punëve të të gjitha niveleve, për të përfshirë përgjegjësitë për barazinë gjinore të cilat janë me rëndësi për ato pozicione. Të sigurohet që PFGJ-të të kenë kohë të mjaftueshme që të përmbushin përgjegjësitë e tyre si PFGJ, krahas përgjegjësive të tjera (objektivi 3).
- Të sigurohet që çështjet gjinore të integrohen në të gjitha trajnimet (objektivi 3).
- Të sigurohet që çështjet gjinore të integrohen brenda të gjitha mostrave që kanë të bëjnë me programimin, mekanizmat e sigurimit të cilësisë, vlerësimet dhe proceset e brendshme të shqyrtimit metodologjik (objektivi 4).
- Të ndryshohet Dokumenti i Planifikimit Sektorial dhe mostrat e DV-ve, me qëllim që në to të kërkohet analiza gjinore, barazia gjinore lidhur me objektivat dhe/ose rezultatet, të dhënat kontrolluese të specifikuara sipas gjinisë dhe synimet që caktohen duke u mbështetur në të dhënat e nxjerra nga analizat gjinore. Këtu përfshihet, aty ku është e mundur, ndarja e të dhënave sipas gjinisë.
- Të krijohet një proces i standardizuar i sigurimit të cilësisë për çështjet gjinore, me ekspertë të çështjeve gjinore, duke shqyrtuar të gjitha DV-të nga pikëpamja gjinore, duke marrë për bazë, mundësisht, praktikatat më të mira të Agjencisë Austriake të Zhvillimit (objektivi 4). Të merret parasysh rishikimi i treguesit 4.2.2, për të pasqyruar krijimin e këtij procesi të institucionalizuar.
- Të kërkohet dhe të sigurohet mbledhja dhe raportimi i informatave më cilësore lidhur me përqindjen e programeve për të cilat DBE-të përdorin gjetje që dalin nga konsultimet që zhvillohen me MKBGJ-të, OSHC-të dhe OSHCG-të për të nxjerrë të dhëna për t'u përdorur gjatë hartimit të veprimeve, në pajtim me treguesin e parashikuar në fillim (objektivi 4).
- Të sigurohet që rishikimet e planifikuara në KRBE-të të përfshijnë edhe treguesit e PVGJ-së II, krahas treguesve të KRBE-së, për raportim të rregullt (objektivi 5). Ndërkohë, të shqyrtohen dhe rishikohen nga afër treguesit e PVGJ-së II për të siguruar që ata të kërkojnë në mënyrë specifike raportimin e të dhënave të ndara sipas gjinive.
- Gjatë projektimit të sistemit OPSYS dhe çdo sistemi tjetër të hedhjes së të dhënave, që përdoret nga DBE-të, të sigurohet që hedhja e duhur e të dhënave që kanë të bëjnë me Shenjuesin Gjinor të KAZH-it të OBEZH-it të jetë e detyrueshme, duke përfshirë edhe arsyetimet e kërkuara për pikët/vlerësimet G0 (objektivi 5). Të merret parasysh përfshirja e një udhëzuesi të shkurtër e më të qartë lidhur me kuptimin e secilës pikë, me qëllim që të bëhen të mundura raportime më të sakta e më objektive.
- Të kërkohet dhe të sigurohet që në sistemin OPSYS dhe në sistemet e tjera të hedhjes së të dhënave, që përdoren nga DBE-të, të mblidhen dhe raportohen informacione me cilësi më të lartë, lidhur me përkrahjen reale që u jepet grave dhe vajzave; OSHCG-ve dhe MKBGJ-ve, qoftë përmes programeve të dedikuara, qoftë si pjesë e integritimit të çështjeve gjinore në programet sektoriale.
- Të kërkohet matje dhe raportim vjetor lidhur me: 1) përkrahjen financiare që u jepet OSHCG-ve dhe 2) organizatave të tjera të OSHC-së që punojnë, përkatësisht, për barazinë gjinore dhe për fuqizimin dhe të drejtat e grave dhe vajzave (objektivi 18).

## **PËR DELEGACIONET E BASHKIMIT EVROPIAN**

- Në përgjithësi, çdo DBE duhet të hartojë një plan veprimi, ku të specifikohen objektivat e prioritetuara të PVGJ-së II dhe veprimet e parashikuara që do të ndërmarrin pjesët e ndryshme të organizatës për t'i realizuar

këto objektiva (p.sh. lidhur me komunikimin, seksionet politike dhe operacionet) me afate kohore të qarta dhe persona përgjegjës për secilin objektiv.

- Të ngrihen rregullisht problematikat lidhur me barazinë gjinore në kuadrin e dialogut politik. Të kërkohet ndihma e PFGJ-ve dhe këshilltarëve politikë në përgatitjen e dokumenteve të shkurtra informuese lidhur me analizën gjinore dhe rekomandimet, të cilat do të përdoren gjatë dialogut politik (objektivi 1). Siç rekomandohet në raportin e vlerësimit, "të theksohet rëndësia e integritetit të çështjeve gjinore në dialogun sektorial, p.sh. në menaxhimin e financave publike, në reformën në administratën publike, në tregti, energjetikë, bujqësi, transport dhe infrastrukturë."<sup>73</sup>
- Të caktohen kampionë të çështjeve gjinore, sidomos burra, të cilët do të marrin përsipër përgjegjësinë për të ngritur vazhdimisht në nivelin kombëtar problematikat që kanë të bëjnë me barazinë gjinore (objektivi 2).
- Udhëheqësit e Misioneve duhet të jenë shembull në lidhshmëri dhe të lidhur me rëndësinë e çuarjes përpara të barazisë gjinore, duke diskutuar rregullisht barazinë gjinore dhe duke theksuar që personeli i DBE-ve duhet t'i nxisë qeveritë përfituese që të çojnë përpara barazinë gjinore (objektivi 2).
- Të projektohen sisteme shpërblimi për të njohur më mirë arritjen e rezultateve lidhur me barazinë gjinore (objektivi 2).
- Të shqyrtohen dhe të përditësohen rregullisht, sipas nevojës, planet e vendit për raportimin mbi objektivat e PV-GJ-së II, duke marrë për bazë sidomos nevojat e reja të identifikuar përmes analizave gjinore dhe konsultimeve të rregullta me OSHCG-të (objektivi 2). Të kryhet një shqyrtim vjetor i brendshëm për të vlerësuar përparimin e DBE-ve në zbatimin e planit të vendit, duke përfshirë përparimin në të gjitha prioritetet, objektivat dhe treguesit e PVGJ-së II.
- Të sigurohet që të gjitha veprimet të përfshijnë analiza gjinore. Nëse sektorëve u mungojnë të dhëna specifike, t'u kërkohet qeverive të bëjnë plane dhe të caktojnë buxhete për veprime përmes të cilave do të përfshihet realizimi i analizave gjinore si pjesë e fazave konceptuese, për të informuar dhe për të integruar më mirë çështjet gjinore në kuadrin e ndërhyrjeve (objektivi 4).
- Të krijohen procese për të siguruar që të gjitha DV-të të shqyrtohen nga perspektiva gjinore nga ana e ekspertëve të çështjeve gjinore që kanë njohuri të hollësishme dhe që e kuptojnë mirë kontekstin lokal, duke siguruar në këtë mënyrë që çështjet gjinore të integrohen në të gjitha DV-të (objektivi 4).
- Edhe pse përgjegjësia përfundimtare mbi programimin është e vendeve përfituese, DBE-të duhet të ushtrjnë më shumë presion politik lidhur me çuarjen përpara të barazisë gjinore si një të drejtë themelore dhe parim të BE-së, duke u dërguar qeverive një mesazh të qartë që barazia gjinore është një përparësi për BE-në dhe se duhet të jetë e tillë edhe për qeveritë (objektivi 4).
- Po ashtu, është përgjegjësia e DBE-ve të sigurojnë që vendet përfituese të zhvillojnë konsultime të mjaftueshme me MKBGJ dhe OSHC, sidomos me OSHCG, gjatë proceseve të hartimit të strategjive, ligjeve dhe DV-ve të reja. Nëse të dhënat nga këto konsultime janë të pamjaftueshme, atëherë, duke vepruar në pajtim me PVGJ-në II, DBE-ja duhet të nxisë fuqimisht, përkrahë dhe sigurojë që qeveria përfituese i organizon këto konsultime (objektivi 4). Këtu përfshihet sigurimi që konsultimet të jenë kuptimplota dhe ndryshimet në DV të kryhen duke marrë për bazë të dhënat hyrëse përkatëse të ofruara nga MKBGJ-të dhe OSHCG-të, sipas nevojës.
- Të sigurohet që të gjithë punonjësit e DBE-ve, të cilët janë të përfshirë në hedhjen e të dhënave në softuerin e menaxhimit elektronik të të dhënave, të njihen me Shënjesin Gjinor të OBEZH-it dhe me mënyrën e përdorimit të tij, ku të shënojnë arsyetime të hollësishme kur programet vlerësohen me pikën G0 (objektivi 5)..
- Të përmirësohet disponueshmëria e të dhënave duke alokuar më shumë burime për hulumtime dhe të dhëna statistike që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë gjinore, duke çuar kështu më tej zbatimin e PVGJ-së II (objektivi 6).

<sup>73</sup> KE, Raporti Vjetor i Zbatimit i vitit 2016, fq. 49.

- Të inkurajohen fuqishëm dhe të përkrahen MKBGJ-të në organizimin e takimeve sistematike koordinuese për çështjet gjinore, ku përfshihen si palët kombëtare të interesit ashtu edhe ato ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e harmonizimit dhe të përputhshmërisë, duke përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e arritjes së rezultateve në drejtim të barazisë gjinore (objektivi 6).
- Të alokohen burime financiare për të mbështetur MKBGJ-të në drejtim të çuarjes më tej të kapaciteteve të tyre për t'u angazhuar në proceset e anëtarësimit të vendeve në BE. Të nxiten fuqishëm vendet për të siguruar përfshirjen e MKBGJ-ve në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve sektoriale specifike (objektivi 6).
- Të alokohen fonde për mbështetjen e ngritjes së ndërgjegjësimit dhe raportimin e medieve për temat që kanë të bëjnë me barazinë gjinore (objektivi 6).
- Të hiqen mënjatë fonde për përkrahjen e OSHCG-ve, duke përfshirë mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave, sidomos në lidhje me zbatimin e PVGJ-së II dhe proceset e anëtarësimit në BE (objektivi 18).<sup>74</sup>

### **LIDHUR ME PVGJ-NË III**

- Të shqyrtohen nga afër dhe të rishikohen treguesit, dhe të sigurohen tregues me të dhëna të ndara sipas gjinive. Të caktohen synimet.
- Të adresohen në mënyrë specifike çështjet e përgjegjësisë mbi DV-të dhe mënyrat specifike përmes të cilave DBE-të mund të çojnë përpara barazinë gjinore gjatë hartimit të programeve.
- Të kërkohet të bëhet harmonizimi i PVGJ-së III me ciklet e programimit.
- Të përfshihet si tregues përkrahja ndaj OSHCG-ve si palë kyçe të interesuara, në kuadrin e çuarjes përpara të barazisë gjinore, si pjesë e aktiviteteve të parashikuara dhe treguesve të PVGJ-së III.
- T'u kushtohet më shumë vëmendje burrave, djemve dhe marrëdhënieve gjinore.

<sup>74</sup> Për rekomandime të hollësishme, shihni, RrGK, "Financimi i BE-së për organizatat e grave në Ballkanin Perëndimor: sfidat dhe mundësitë", 2017, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20171201123609371.pdf>.

---

## BURIMET E CITUARA

---

- Capacity4dev, "EU Results Framework Indicators [Treguesit e Kornizës së Rezultateve të BE-së]", marrë nga: <https://europa.eu/capacity4dev/eu-rfi>.
- Chen, Martha, dhe Marilyn Carr, "Globalization, Social Exclusion and Work: With Special Reference to Informal Employment and Gender [Globalizimi, përjashtimi social dhe puna: Vëmendje e posaçme ndaj punësimit informal dhe çështjeve gjinore]", International Labour Review 143, 2004, marrë nga: [http://www.inclusivcities.org/wp-content/uploads/2012/08/Carr\\_Chen\\_ILO\\_Gender\\_and\\_Globalisation.pdf](http://www.inclusivcities.org/wp-content/uploads/2012/08/Carr_Chen_ILO_Gender_and_Globalisation.pdf).
- Komiteti për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore, "REPORT on EU funds for gender equality [RAPORT për fondet e BE-së për barazinë gjinore]", (2016/2144(INI)), A8-0033/2017, 8 shkurt 2017.
- CONCORD, CONCORD Analysis and Recommendations Gender Action Plan Report 2016 [Analiza dhe rekomandimet e CONCORD-it: Raporti për veprimin gjinor 2016], shtator 2017, marrë nga: <http://www.concord.se/wp-content/uploads/final-concord-analysis-on-gap-progress-report.pdf>.
- Këshilli i Bashkimit Evropian, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, "Përfundimet e Këshillit lidhur me Planin e Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020", Bruksel: 26 tetor 2015, 13201/15 DEVGEN 200 SOC 598 ACP 148 ONU 131 RELEX 841 COHAFA 98 COHOM 98, marrë nga: <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/26-fac-conclusions-gender-development/>.
